# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5478
E enjte, 17 maj 2018
çmimi 0.40 €


## Limaj: Rritja e investimeve në sektorin mineral zhvillon ekonominë

FAQE 9





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", ENVER HOXHAJ FAQE 4-5

# Brukseli ka vlerësim unanim se janë përmbushur kushtet për liberalizim



Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, pas kthimit nga Brukseli, ku ka qëndruar për vizitë dhe që për temë diskutimi me zyrtarët e BE-së ka pasur liberalizimin e vizave, ka bërë me dije se tashmë ka një vlerësim unanim në Bruksel se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet sa i përket procesit të liberalizimit të vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se më në këtë proces nuk ka asgjë të paqartë. Sipas Hoxhajt, në BE ka një vendosmëri që procesi i liberalizimit të vizave të lëvizë përpara me shpejtësi të madhe dhe të përmbyllet sa më shpejt. Hoxhaj ka thënë se tani institucionet e Kosovës duhet të fokusohen te lobimi nëpër disa vende kyçe të BE-së

## KDI-ja: Kuvendi nuk u shfrytëzua për dialog konstruktiv e përfaqësim politik




Kuvendi gjatë kësaj legjislature është ballafaquar me sfida që e kanë rrezikuar funksionimin e tij. Kështu është thënë në debatin e organizuar nga KDI-ja për monitorimin e punës së Kuvendit. Albert Krasniqi nga ky institut ka thënë se Kuvendi është shfrytëzuar për qërim hesapesh personale dhe jo për dialog konstruktiv e përfaqësim politik. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli është shprehur i pakënaqur me dinamikën e punës së Kuvendit duke thënë se agjenda legjislative është stërmbushur me tema që nuk i takojnë FAQE 3

## Niveli i ndotjes së ajrit në Kosovë, i dëmshëm për shëndetin e qytetarëve



Auditori i përgjithshëm Besnik Osmani ka thënë se ndotja e ajrit në Kosovë është shqetësuese për shëndetin e qytetarëve. Sipas tij, edhe më shqetësues është fakti se qytetarët nuk janë të informuar në kohë reale për të FAQE 5

## AKTUALE

### DY INTERVISTA NGA DY PEHLIVANË, NJËRI ME SHAJKAQË, TJETRI ME 'XHAMADAN'! F. 11



BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA

### LUAN HARADINAJ DHE LUFTA ÇLIRIMTARE F. 11



PROF. DR. EMIN KABASHI

### NDRYSHIMI I FORMATIT TË DIALOGUT TË BRUKSELIT KTHEN PROCESIN PRAPA F. 7

## EKONOMI

### FILLON ZBATIMI I PAGESAVE ONLINE PËR POLICAT KUFITARE F. 6

### ALIU I VENDOSUR PËR TRANSPARENCË KOMUNALE F. 6

## SPORT



### THAQI: GJILANI NUK KA FRIKË NGA VËLLAZNIMI F. 18

### MË 26 MAJ TURNEU 'LAH NIMANI' F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Sot në Sofje të Bullgarisë mbahet Samiti BE - Ballkani Perëndimor

# Takimi i Sofjes dhe perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor

Samiti i Sofjes shihet si një rikthim i vëmendjes së Bashkimit Evropian drejt Ballkanit pas një periudhe të gjatë dhe pritet që zyrtarët evropianë do të vënë theksin te normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pjesëmarrës në këtë samit është edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi



Predsjedništvo BiH (STA/Daniel Novaković) (Courtesy Photo)

PRISHTINË, 16 MAJ - Takimi i nivelit të lartë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor sot (e enjte) do t'i mbledhë zyrtarët e lartë të mbi 30 vendeve evropiane në Sofje të Bullgarisë. Takimi që është i pari i këtij lloji pas 15 vjetësh, synon ta rikonfirmojë ardhmërinë evropiane të vendeve të rajonit.
Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, tha se takimi i së enjtes është një mundësi për të dyja palët. "Për të ritheksuar se ardhmëria evropiane mbetet zgjedhje gjeostrategjike e Ballkanit. Ne duam të demonstrojmë se na intereson zhvillimi social ekonomik i rajonit. Investimi në lidhjet infrastrukturore dhe njerëzore me dhe brenda Ballkanit Perëndimor është në interesin më të mirë të Bashkimit Evropian. Shpresojmë t'i sjellim më afër miqtë tanë nga Ballkani Perëndimor", ka thënë Tusk.
Takimi i sotëm shihet si një rikthim i vëmendjes së Bashkimit Evropian drejt Ballkanit pas një periudhe të gjatë, por ai nuk pritet të jetë më konkret nga ç'kishte qenë takimi i Selanikut 15 vjet më parë.
Zyrtarët evropianë pritet ta ritheksojnë qëndrimin se Bashkimi Evropian nuk do të pranojë asnjë vend që nuk i ka të zgjidhura konfliktet dypalëshe, duke vënë theksin te normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe zgjidhja e kontestit rreth emrit të Maqedonisë.
Udhëheqësit e lartë evropianë do të trajtojnë këtu në Sofje gjatë dy ditëve edhe sfidat e tjera me të cilat përballet Bashkimi Evropian. Tusk tha të mërkurën se të gjitha diskutimet e sotme dhe të nesërme kanë edhe dimensionin e tyre global. "Për të qenë subjekt dhe jo objekt i politikës globale, Evropa duhet të jetë e bashkuar ekonomikisht, politikisht dhe po ashtu ushtarakisht si kurrë më parë", tha ai duke nënvizuar se, përveç sfidave tradicionale politike, siç janë ndikimi i Kinës dhe qasja agresive e Rusisë, tash Evropa po përballet me dukurinë e re që ai e quajti qasje tekanjoze të administratës amerikane.
Në këtë takim do të marrë pjesë edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili të mërkurën ka arritur në Sofje.
Presidenti Thaçi, i cili e kryeson delegacionin e Kosovës, në margjina të këtij samiti pritet të zhvillojë edhe takime bilaterale me liderë shtetërorë të vendeve të Bashkimit Evropian, kurse sot (e enjte) pasdite do të marrë pjesë edhe në Forumin Ekonomik Botëror që organizohet në Sofje.
Në të kaluarën, në samite përafërsisht të kësaj natyre, Kosova ishte prezantuar nga shefat e UNMIK-ut. Në Samitin e Zagrebit në vitin 2000, Kosova ishte përfaqësuar nga Bernard Kouchner, kurse në Samitin e Selanikut nga Michael Steiner. Pjesëmarrja e Kosovës në këtë Samit po konsiderohet si historike.

## Rama kundër idesë për 'Shqipërinë e madhe'



TIRANË, 16 MAJ - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se vendi i tij e ka për obligim t'i mbrojë shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve të shtetit shqiptar. Duke folur për "Euronews", Rama ka thënë se shqiptarët në Ballkan kurrë nuk kanë qenë në pozitë më të mirë se sot. "Në Kushtetutën tonë ne kemi detyrimin për t'i mbrojtur shqiptarët jashtë vendit kudo, por në të njëjtën kohë mendoj se shqiptarët nuk kanë qenë kurrë më të mirë se sot, kudo që jetojnë. Pra, në Kosovë ata kanë shtetin e tyre tani. Në Maqedoni ata janë pjesë e një revolucioni të vërtetë në drejtim të ndryshimit të qasjes ndaj gjuhës shqipe dhe ndaj popullit shqiptar. Në jug të Serbisë shpresoj se kushtet e tyre do të përmirësohen, duke u bazuar edhe në faktin se serbët në Kosovë trajtohen shumë më mirë", ka thënë Rama.
Rama ka thënë se është kundër krijimit të Shqipërisë së Madhe. "Unë gjithmonë kam thënë se kam një ëndërr që në të bashkohemi nën një qiell të Bashkimit Evropian dhe kurrë nuk kam ëndërruar për një Shqipëri të madhe sepse kam ëndrra të mëdha, për një 'Evropë të Madhe', me të gjithë shqiptarët brenda", ka thënë Rama.

## Meta takon Jahjagën



TIRANË, 16 MAJ - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, priti në një takim të përzemërt ish-presidenten e Kosovës, Ahtifete Jahjaga. "Fuqizimi i rolit të gruas në të gjitha fushat e jetës mbetet një sfidë që meriton më shumë angazhim dhe vëmendje nga të gjithë", ka theksuar presidenti Meta.
Edhe ish-presidentja e Kosovës e ka vlerësuar takimin me Ilir Metën. "Sot pata një takim shumë të mirë me presidentin Ilir Meta, me të cilin bisedova mbi sfidat me të cilat ballafaqohen shoqëritë tona dhe praktikat më të mira për një zhvillim të qëndrueshëm shoqëror", ka shkruar Jahjaga në rrjetet sociale. Atifete Jahjaga gjatë qëndrimit në Tiranë është takuar edhe me shkrimtarin Ismail Kadare.

## Lëvizja Besa dhe PDSh-ja bëhen pjesë e Qeverisë së Maqedonisë



SHKUP, 16 MAJ - Koalicioni qeverisës në Maqedoni është zgjeruar edhe me dy parti politike, Lëvizjen Besa që drejtohet nga Afrim Gashi dhe Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH) të Menduh Thaçit. Dy partitë, që deri tani ishin në opozitë, i janë bashkuar Lidhjes Socialdemokrate të kryeministrit Zoran Zaev dhe Bashkimit Demokratik për Integrim të Ali Ahmetit, që së bashku me disa parti të tjera të vogla rrisin numrin e përbërjes parlamentare në 68 deputetë.
Kuvendi Qendror i Lëvizjes Besa të drejtuar nga Afrim Gashi gjatë mbledhjes së mbajtur të martën vendosi të bëhet pjesë e Qeverisë dhe ta pranojë kështu Ministrinë e Kulturës, e cila drejtohej nga LSDM-ja. PDSh-ja e Menduh Thaçit në Qeverinë e Zoran Zaevit do të udhëheqë postin e ministrit për Investime të Huaja dhe do ta ketë një zëvendësministër për Transport dhe Lidhje.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka prezantuar platformën "Vota ime" për monitorimin e punës së Kuvendit dhe të deputetëve

# KDI-ja: Kuvendi nuk u shfrytëzua për dialog konstruktiv e përfaqësim politik




**Kuvendi gjatë kësaj legjislature është ballafaquar me sfida që e kanë rrezikuar funksionimin e tij. Kështu është thënë në debatin e organizuar nga KDI-ja për monitorimin e punës së Kuvendit. Albert Krasniqi nga ky institut ka thënë se Kuvendi është shfrytëzuar për qërim hesapesh personale dhe jo për dialog konstruktiv e përfaqësim politik. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli është shprehur i pakënaqur me dinamikën e punës së Kuvendit duke thënë se agjenda legjislative është stërmbushur me tema që nuk i takojnë**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 MAJ - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) të mërkurën ka prezantuar platformën "Vota ime" për monitorimin e punës së Kuvendit dhe të deputetëve, me ç'rast është thënë se gjatë kësaj periudhe Kuvendi ka pasur shumë pak produktivitet.

Përfaqësuesi i KDI-së, Albert Krasniqi, ka thënë se Kuvendi është shfrytëzuar për qërim hesapesh personale dhe jo për dialog konstruktiv e përfaqësim politik. Sipas tij, mbikëqyrja parlamentare ka qenë e dobët, kurse sa i përket transparencës është shënuar progres. "Sfidat me të cilat është ballafaquar Kuvendi kanë qenë të shumta dhe jo rrallëherë kanë rrezikuar funksionimin e tij. Polarizimet ndërmjet partive në pushtet dhe atyre në opozitë janë shtuar. Kuvendi është shfrytëzuar shpeshherë për qërim të hesapeve personale dhe jo për dialog konstruktiv e përfaqësim politik. Mungesat e deputetëve në seanca dhe mbledhje të komisioneve po vazhdojnë të jenë problem. Mbikëqyrja parlamentare është e dobët. Gjysma e deputetëve nuk ka pasur asnjë pyetje për Qeverinë në këtë legjislaturë. Interpelancat nuk i kanë shërbyer funksionit për të cilën janë thirrur. Qeveritarët shpeshherë kanë qasje shpërfillëse ndaj Kuvendit, nuk u përgjigjen ftesave të komisioneve për raportim. Sa i përket transparencës, Kuvendi ka shënuar progres", ka deklaruar Krasniqi. Ai ka bërë me dije se KDI-ja gjatë këtyre dymbëdhjetë vjetëve të monitorimit të Kuvendit ka identifikuar shumë mangësi si dhe ka dhënë rekomandime të shumta. "Pas 12 vjetësh monitorim të rregullt të punës së Kuvendit, KDI synon që tanimë të krijojë një qasje tjetër të monitorimit, duke përfshirë qytetarët, shoqërinë civile, studentët dhe grupe të tjera të interesit duke u ofruar mundësi për monitorimin e punës së deputetëve përmes përdorimit të mjeteve të teknologjisë dhe informimit", është shprehur ai.

Ndërsa kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se agjenda e Kuvendit është duke u stërngarkuar me çështje që nuk i takojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë Kuvendit dhe, sipas tij, shumë çështje që po diskutohen po kalojnë në çështje personale. "Kuvendi ka pasur pak produktivitet. Kuvendi është stërngarkuar me çështje që nuk i takojnë punës së tij dhe deputetëve", ka thënë Veseli, duke shtuar se një pjesë e deputetëve bëjnë punë të mirë, por pjesa tjetër vijnë sa për t'u nënshkruar. "Kemi vështirësi në kuorum, sepse ka deputetë që vijnë vetëm që të nënshkruhen dhe kjo po ndikon në punën e mirë të shumë deputetëve të tjerë. Janë deputetë pothuajse të njëjtë që janë pasivë edhe në punën e komisioneve parlamentare", ka theksuar ai.

Kryeparlamentari Veseli ka vlerësuar se roli kritik i shoqërisë civile dhe medieve i kontribuon përmirësimit të punës së Kuvendit. "Në këtë drejtim rolin e KDI-së e vlerësoj në mënyrë pozitive meqë ka qenë afër nesh jo vetëm për kritika, por edhe për këshilla për përmirësimin e punës sonë, veçanërisht për rritjen e transparencës. Kuvendi aktualisht është institucioni më transparent dhe me qasje të plotë, por kemi nevojë për bashkëpunim më të madh", ka thënë Veseli.

Ai ka theksuar se platforma e prezantuar nga KDI-ja është kontribut për avancimin e demokracisë përfaqësuese. "Duke forcuar dhe avancuar standardet demokratike të qeverisjes, ne përshpejtojmë rrugën e integrimeve evropiane të vendit tonë. Duke forcuar dhe avancuar standardet demokratike të qeverisjes, ne krijojmë kushtet e domosdoshme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe ngritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve", ka deklaruar Veseli. Kurse Artan Murati nga KDI-ja ka prezantuar platformën "Vota ime", për të cilën ka thënë se ofron mundësi të shumta në monitorimin e punës së Kuvendit si tërësi dhe deputetëve individualisht. Ai ka theksuar se, pavarësisht prej faktit se Kuvendi është një nga institucionet më transparente në vend, ky institucion është duke u përballur me mosefikasitet të punës. Murati ka deklaruar se funksionimi i Kuvendit është përcjell me mungesën e shpeshtë të kuorumit si dhe numrin e vogël të ligjeve të miratuara.

## OSBE-ja kërkon të vërtetën për gazetarët e vrarë apo të zhdukur në Kosovë

PRISHTINË, 16 MAJ - Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë u ka bërë thirrje autoriteteve të drejtësisë në Kosovë që t'i shtojnë përpjekjet për t'i zbardhur rastet e gazetarëve të cilët janë rrëmbyer, vrarë apo zhdukur gjatë apo pas periudhës së luftës në Kosovë.

Në Kryeprokurorinë e Shtetit thonë se nga marsi i vitit 2017 kryeprokurori i Shtetit, Aleksander Lumezi, ka caktuar një prokuror-koordinator për rastet e kanosjeve apo veprave të tjera penale që kryhen ndaj gazetarëve.

Këshilltarja e Kryeprokurorit të Shtetit, Merita Gashi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se edhe lidhur me rastet e vrasjeve apo zhdukjes së gazetarëve të kohës së luftës, prokuroritë po punojnë për zbardhjen e tyre. "Për të gjitha rastet, përfshirë ato edhe gjatë luftës dhe pas luftës, Prokuroria është duke punuar dhe hetuar intensivisht që këto raste të zbardhen sa më shpejt', ka thënë Gashi.

Senad Shaboviq, zëdhënës i OSBE-së në Prishtinë, ka bërë me dije se, sipas informatave të këtij misioni, janë 15 gazetarë shqiptarë dhe serbë të cilët janë vrarë, kidnapuar apo zhdukur.

Flet për "Epokën e re", Enver Hoxhaj

# Brukseli ka vlerësim unanim se janë përmbushur kushtet për liberalizim



**Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, pas kthimit nga Brukseli, ku ka qëndruar për vizitë dhe që për temë diskutimi me zyrtarët e BE-së ka pasur liberalizimin e vizave, ka bërë me dije se tashmë ka një vlerësim unanim në Bruksel se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet sa i përket procesit të liberalizimit të vizave. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka thënë se më në këtë proces nuk ka asgjë të paqartë. Sipas Hoxhajt, në BE ka një vendosmëri që procesi i liberalizimit të vizave të lëvizë përpara me shpejtësi të madhe dhe të përmbyllet sa më shpejt. Hoxhaj ka thënë se tani institucionet e Kosovës duhet të fokusohen te lobimi nëpër disa vende kyçe të BE-së**

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 16 MAJ - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka bërë me dije se në Bashkimin Evropian ka vlerësim unanim se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizim të vizave. Ai ka thënë se në kryeqendrën e BE-së ka një vendosmëri që ky proces të lëvizë përpara me shpejtësi të madhe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", pas vizitës në Bruksel, Hoxhaj ka treguar se qëllimi i kësaj vizite ishte që ta marrë një plan kohor se kur fillon vendimmarrja në Bruksel për këtë proces dhe brenda çfarë periudhe kohore qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin pa viza. "Ka një vlerësim unanim në Bruksel se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet sa i përket procesit të liberalizimit të vizave. Po ashtu, ka një vendosmëri që procesi të lëvizë përpara me shpejtësi të madhe", është shprehur Hoxhaj.

Ndonëse nuk ka përmendur ndonjë datë se kur mund të lëvizin qytetarët e Kosovës pa viza, ai ka lënë të kuptohet se kjo mund të ndodhë gjatë këtij viti. Sipas tij, data e saktë do të dihet vetëm pas vendimmarrjes në institucionet e BE-së. "Se sa do të zgjasë kjo fazë është diçka që do të duhen disa javë, pastaj mund të hyjmë në një qartësi se kur Komisioni Evropian mund të marrë vendim që qytetarët e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza drejt Evropës. Por, ka një shpejtësi të re, një vullnet të ri për këtë çështje. Nuk ka ndonjë paqartësi, por ka një partneritet të mirëfilltë në mes të partnerëve evropianë që të na ndihmojnë në një proces të tillë", ka thënë Hoxhaj.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka deklaruar se tani institucionet e Kosovës duhet të fokusohen te lobimi nëpër disa vende kyçe të BE-së. Hoxhaj ka theksuar se në këtë proces nuk ka vend për pesimizëm. "Besoj se nuk ka arsye për pesimizëm por, përkundrazi, ka arsye për optimizëm. Ne duhet të shohim që ta mbajmë gjallë këtë agjendë dhe në vend se të japim data në Prishtinë, të bëjmë punë konkrete lobuese në Bruksel dhe në qendrat e tjera evropiane", ka thënë Hoxhaj.

**"Epoka e re":** *Z. Hoxhaj, sapo keni përmbyllur një vizitë në Bruksel. Cili ishte qëllimi i saj?*

**Hoxhaj:** Qëllimi i vizitës sime në Bruksel ka qenë të marrim një plan kohor se kur fillon vendimmarrja në Bruksel sa i takon procesit të liberalizimit të vizave, pra kur përmbyllet ky proces dhe kur do të mund të udhëtojnë qytetarët e Kosovës pa viza drejt Evropës. Sikurse në Kosovë që ka një procedurë kur Qeveria merr vendime dhe duhet t'i sjellë në parlament, po ashtu edhe në Bruksel duhet të ketë një vendim të Komisionit Evropian që në këtë rast është ekzekutivi i BE-së, që ia jep një propozim Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, i cili përbëhet prej shteteve anëtare me qëllim që të përmbyllet sa më shpejt ky proces.

**"Epoka e re":** *Çfarë është vlerësimi i zyrtarëve të BE-së dhe zyrtarëve të vendeve anëtare rreth përmbushjes së kushteve për liberalizim të vizave nga ana e Kosovës?*

**Hoxhaj:** Ka një vlerësim unanim në Bruksel, se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet sa i përket procesit të liberalizimit të vizave. Po ashtu, ka një vendosmëri që procesi të lëvizë përpara me shpejtësi të madhe.

**"Epoka e re":** *Kur mund të presim një vendim të institucioneve të BE-së për liberalizim të vizave?*

**Hoxhaj:** Sipas procedurave, Komisioni Evropian ka dërguar një grup të ekspertëve i cili ka qëndruar në Prishtinë javën e kaluar. Ky grup i ekspertëve duhet ta hartojë një raport, i cili pastaj nga Komisioni Evropian do të shkojë fillimisht në një komision pranë Parlamentit Evropian që merret me viza dhe të cilin e udhëheq Tanja Fajon. Pastaj, Komisioni Evropian me Parlamentin Evropian dhe Këshillin Evropian duhet të zhvillojnë një lloj komunikimi rreth përmbushjes së kritereve, duke i përfshirë këto të fundit, sikurse ka qenë demarkacioni me Malin e Zi dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Se sa do të zgjasë kjo fazë është diçka që do të duhen disa javë, pastaj mund të hyjmë në një qartësi se kur Komisioni Evropian mund të marrë vendim që qytetarët e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza drejt Evropës. Por, ka një shpejtësi të re, një vullnet të ri për këtë çështje. Nuk ka ndonjë paqartësi, por ka një partneritet të mirëfilltë në mes të partnerëve evropianë që të na ndihmojnë në një proces të tillë.

**"Epoka e re":** *Çfarë do të thotë ky vullnet i ri nga ana e institucioneve të BE-së?*

**Hoxhaj:** Vullneti i ri dhe vendosmëria kanë të bëjë me atë se Kosova i ka kryer punët të cilat do të duhej t'i kryente. Ne nuk jemi në gjendje t'u caktojmë datë atyre në kuptimin e javëve dhe muajve, por u takon vetë institucioneve të BE-së të dalin me një plan kohor dhe ta përmbushin procesin e konsultimeve të brendshme dhe ta mbyllin këtë proces. Në të njëjtën kohë ne duhet të shohim se si duhet të bashkëpunojmë me disa shtete anëtare të BE-së, veçanërisht me Gjermaninë, ku kam qëndruar para dy jave, me Francën, me Austrinë, por edhe me Holandën, Belgjikën, si dhe disa shtete anëtare, meqë vendimmarrja e Komisionit Evropian është një vendimmarrje ku vendos komisionari për Migrim dhe Çështje të Brendshme, Dimitris



Avramopoulos, të cilin e kam takuar gjatë kësaj vizite dhe komisionarin për Zgjerim dhe Fqinjësi të Mirë, Johannes Hahn. Besoj se nuk ka arsye për pesimizëm por, përkundrazi, ka arsye për optimizëm. Ne duhet të shohim ta mbajmë gjallë këtë agjendë dhe në vend se të japim data në Prishtinë, të bëjmë punë konkret lobuese në Bruksel dhe në qendrat e tjera evropiane.

**"Epoka e re":** *Ka ndonjë shtet anëtar të BE-së i cili mund të paraqesë ndonjë pengesë në këtë proces? Frika çdoherë është te pesë vendet që ende nuk e kanë njohur ende Kosovën shtet.*

**Hoxhaj:** Jo. Mënyra se si merret vendimi ka të bëjë me shumicë të kualifikuar që janë 55 për qind e votave, e cila nënkupton 65 për qind të popullatës së BE-së. Unë kam folur edhe me vendet anëtare të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën shtet dhe të cilat janë mbështetëse të këtij procesi. Kështu që, nuk shoh se mund të dalë ndonjë problem rrugës. Mirëpo, procesi derisa të mbyllet do të zgjasë disa muaj, mandej do të merret vendimi, pastaj dihet data e saktë se kur qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin pa viza drejt BE-së.

**"Epoka e re":** *Në bazë të dinamikës që keni parë nga afër, mund të presim që të lëvizim pa viza gjatë këtij viti?*

**Hoxhaj:** Nuk jam ithtar i saj që ne nga Prishtina t'i japim afate dikujt në Bruksel, apo nga Prishtina t'i japim afate dikujt në Berlin, Paris, apo në qendrat e tjera evropiane. Ajo çfarë mund të them është se vendet e rajonit, prej kohës kur është mbyllur procesi i konsultave të brendshme në Bruksel, pra mes institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare, ky proces është përmbyllur brenda disa muajve. Në vitin 2009, në një afat kohor 6 deri në 7 muaj, Shqipëria, Maqedonia, Bosnja, Serbia dhe Mali i Zi kanë mundur të udhëtojnë pa viza drejt BE-së. Pra, është një proces i cili mund të marrë disa muaj kohë, por nuk jam për atë që ne në Prishtinë të kultivojmë një gjuhë dhe një diskurs agresiv. Jam për atë që aty ku merren vendimet të jemi të prerë dhe ta dimë se çfarë po duam.

# Niveli i ndotjes së ajrit në Kosovë, i dëmshëm për shëndetin e qytetarëve

Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, ka thënë se ndotja e ajrit në Kosovë është shqetësuese për shëndetin e qytetarëve. Sipas tij, ende më shqetësues është fakti se qytetarët nuk janë të informuar në kohë reale për këtë problematikë

**Prishtinë, 16 maj (ER)** - "Gjatë viteve 2016 dhe 2017 parametrat e rrezikshëm për shëndetin e njeriut, siç janë grimcat e pluhurit PM10 dhe PM2.5, nuk janë raportuar për muaj të tërë, sidomos gjatë muajve të dimrit kur këta parametra arrijnë vlera maksimale. Pavarësisht prej monitorimit dhe raportimit të mangët, në ato raste kur është raportuar janë regjistruar tejkalime alarmante të parametrit PM10 që kanë arritur deri në 400 % tejkalim", kështu është thënë në konstatimin e Zyrës së Auditorit.

Në komunikatën për medie të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës thuhet se grimcat e pluhurit janë shumë të rrezikshme për shëndetin e njeriut pasi janë grimca me diametër shumë të vogël dhe, si të tilla, mund të udhëtojnë më thellë në mushkëri e që pastaj shkaktojnë efekte të dëmshme për shëndetin. "Efektet e mundshme që mund të shkaktohen nga këto grimca janë rritja e numrit të të sëmurëve me astmë bronkiale, bronkitet kronike, sëmundjet kronike të mushkërive tek moshat e shtyra, rritja e numrit të sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore, kanceri, shkurtimi i jetës si dhe rritja e shkallës së mortalitetit", është theksuar në këtë komunikatë.

Raporti i auditimit të performancës, "Mekanizmat institucionalë për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit", ka gjetur se sistemi i tillë i monitorimit dhe raportimit, që menaxhohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe mekanizmat e saj, nuk u ofron qytetarëve të Kosovës një pasqyrë reale të gjendjes së cilësisë së ajrit, sidomos jo në kohë reale. "Ky sistem i monitorimit dhe raportimit përbën rrezikun që të jetë jofunksional e pa të dhëna sidomos në ato raste kur ndotja e ajrit në vend është shumë e rëndë dhe qytetarët të mos jenë në dijeni në kohën e duhur për t'i marrë masat e nevojshme për ta evituar ekspozimin ndaj ndotjes së ajrit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor po ashtu nuk ka kompletuar gjithë infrastrukturën e nevojshme ligjore dhe fizike për menaxhimin e gjendjes së cilësisë së ajrit si dhe nuk e ka azhurnuar gjithë infrastrukturën ekzistuese ligjore sipas gjendjes aktuale të cilësisë së ajrit", është thënë në komunikatën e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

Lidhur me këtë konstatim ka folur edhe Auditori i Përgjithshëm Besnik Osmani. "Ndotja e ajrit në Kosovë është shqetësuese për shëndetin e qytetarëve. Ende më shqetësues është fakti se qytetarët nuk janë të informuar me kohë dhe si duhet për këtë problematikë", ka thënë ai.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë rekomandimet e veta, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se autoritetet përgjegjëse, respektivisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti Hidrometeorologjik si dhe komunat, t'i shtojnë përpjekjet e tyre për krijimin e një kornize të plotë ligjore dhe fizike, si dhe mekanizmave të qëndrueshëm dhe efikas të monitorimit dhe raportimit. "Përmirësimi i ngecjeve të identifikuara do të ndihmojë në identifikimin e masave konkrete për t'u ndërmarrë për të përmirësuar gjendjen e cilësisë së ajrit", është thënë komunikatën e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës.



# Shërbimet mjekësore në Therandë po avancohen

THERANDË, 16 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka thënë se shërbimet mjekësore në këtë komunë janë në proces të avancimit. Ai ka bërë me dije se si komunë kanë intervenuar duke hapur dhe riaktivizuar qendra të reja mjekësore. "Qytetarët për gjithçka dhe mbi gjithçka duhet të jenë të parët. Vetëm mbi këtë vullnet dhe këtë energji ne e fitojmë besimin e tyre. Jam të vetëdijshëm edhe për mungesën e kushteve, të barërave esenciale ku qytetari, krahas kushteve të vështira, duhet t'i blejë ato", ka thënë Muharremaj.

Ai ka inkurajuar stafin mjekësor në Therandë ta japë kontributin në shërbim të qytetarëve. "Si kryetar komune stafin mjekësor e inkurajoj që, në raste të tilla, dhimbjet dhe shqetësimet e qytetarëve t'i shoqërojnë me sjellje të mira që transmetojnë vullnet. Ju falënderohem për punën e mirë, por gjithmonë ka mundësi për përmirësime. Punoni me vullnet që ta keni edhe përkrahjen institucionale, po ashtu falënderimin e qytetarëve", ka deklaruar Muharremaj.





# Aliu i vendosur për transparencë komunale

FERIZAJ, 16 MAJ (ER) - Të enjten është bërë publike për herë të parë lista e shfrytëzuesve afatshkurtër dhe afatgjatë të pronave komunale në Ferizaj. Kjo listë pasqyron shfrytëzuesit e pronave komunale dhe është në funksion të interesit publik, gjegjësisht të drejtës për informim lidhur me shfrytëzuesit e pronës komunale si dhe realizimit të projekteve që për qëllim kanë nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe uljen e papunësisë. "Këtij procesi i ka paraprirë një verifikim në terren i gjendjes dhe kushteve të shfrytëzimit të pronës komunale. Ky proces është realizuar me nismën e kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliu dhe zbatimin nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. Publikimi i këtij dokumenti është në vazhdën e bërjes transparente të dokumenteve të rëndësishme dhe me interes të publikut në Komunën e Ferizajt", është thënë në njoftimin e Komunës së Ferizajt.

# Jashari e Reshitaj nënshkruajnë katër memorandume bashkëpunimi

SKENDERAJ, 16 MAJ (ER) - KRYETARI i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Albena Reshitaj, kanë nënshkruar katër memorandume mirëkuptimi për mbështetjen e projekteve në këtë komunë. Me këtë rast, kryetari Jashari ka theksuar se këto projekte janë shumë të rëndësishme për qytetarët e Skenderajt. Ndërsa ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka thënë se me Komunën e Skenderajt ky është vetëm fillimi i bashkëpunimit. "Do të vazhdojmë bashkë, me mundësi dhe kapacitete të tjera", ka thënë Reshitaj.



# Platforma digjitale i tregon Ahmetit për dëmtimet në kryeqytet

PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka bërë me dije se platforma digjitale është duke shërbyer në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në kryeqytet, me ndihmën e qytetarëve. Ahmeti këtij njoftimi i ka bashkangjitur një fotografi ku shihet dëmtimi i shenjës së komunikacionit në një rrugë në kryeqytet, pastaj për këtë dëmtim është lajmëruar nga qytetarët në kuadër të platformës digjitale.





# Malisheva përfiton mbi 77 mijë euro nga DEMOS-i

MALISHEVË, 16 MAJ (ER) - Komuna e Malishevës, në kuadër të programit DEMOS për vlerësim të performancës komunale, është përfituese e projektit për ndërtimin e rrethojës dhe rezervuarit të ujit për pije në fshatin Senik. Ky projekt është bashkëfinancim në mes të Komunës së Malishevës, Helvetas Swiss Intercooperation dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, projekti nga granti i performancës do të kushtojë 114 089 euro dhe është bashkëfinancim me komunën.

Pjesa e financuar nga granti i performancës (DEMOS) është 77 964 euro, ndërsa pjesa e Komunës së Malishevës është 36 125 euro. Përmes këtij projekti synohet të realizohet një pjesë e rëndësishme e ndërtimit të sistemit të ujësjellësit nga fshati Senik, ku do të furnizohen me ujë edhe dymbëdhjetë fshatra të tjerë të Komunës së Malishevës.



# Ndryshimi i formatit të dialogut të Brukselit kthen procesin prapa




PRISHTINË, 16 MAJ - Ndryshimi i formatit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel do ta kthente procesin prapa, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në Kosovë. Dialogu i deritashëm në Bruksel, për formatin e të cilit që në fillim ishin pajtuar të dy vendet, është zhvilluar me lehtësimin e Bashkimit Evropian dhe me mbështetjen e fuqishme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, së fundmi, për liderët institucionalë të Kosovës, roli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë dialog është vlerësuar i pamjaftueshëm.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, kanë kërkuar përfshirjen aktive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialogun e Brukselit. Politologu Ramush Tahiri thotë për "Radion Evropa e Lirë" se përfshirja eventuale në dialog, në mënyrë aktive e aktorëve të tjerë, përveç Bashkimit Evropian, do të nënkuptonte ndryshim të formatit të dialogut të deritashëm në Bruksel. Rrjedhimisht, sipas tij, procesi do të kthehej prapa. "Pala e Kosovës ka kërkuar të kyçen Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që duket krejtësisht një kërkesë normale, si një lloj garancie. Gjithashtu, pala serbe ka kërkuar të kyçet Rusia e që nga pikëpamja e tyre do të dukej në kuadër të një balance. Mirëpo, problemi kthehet në gjenezën e tij. Unë mendoj se Fuqitë e Mëdha e kanë politikën e vet strategjike dhe gjeopolitike, pavarësisht prej kërkesave të shteteve të vogla, në këtë rast të Kosovës ose edhe të Serbisë", ka theksuar Tahiri.

Ilir Ibrahimi, analist i çështjeve politike, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka shprehur mendimin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të përfshira në dialog, me vetë mbështetjen që i kanë dhënë atij. Sipas tij, kërkesa e autoriteteve të Kosovës që roli i ShBA-së të jetë aktiv në dialog dhe kërkesa e autoriteteve të Serbisë që në dialog të kyçet edhe Rusia, e kthejnë procesin prapa. "Besoj se Bashkimit Evropian i është besuar roli që ta përmbyllë këtë proces të dialogut dhe Bashkimi Evropian, në këtë rast i përfaqësuar nga zonja (Federica) Mogherini, e ka përkrahjen e fuqishme si nga shtetet e Bashkimit Evropian, sidomos ato që e kanë njohur Kosovën, por edhe nga Shtetet e Bashkuara. Prandaj, çdo ndryshim i kompozimit të pjesëmarrësve në dialog tani, unë po besoj se nuk është në favor të Kosovës, sepse në momentin që futet edhe Rusia në këtë lojë, atëherë e kemi një rol tjetër të dialogut. Kjo nuk do të shkonte në favor të Kosovës. Prandaj edhe e kemi parë që Shtetet e Bashkuara nuk kanë qenë në favor të përfshirjes aktive në dialog", ka thënë Ibrahimi.

Në anën tjetër, në nismën e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Bashkimi Evropian nuk ka marrë mbi vete barrën që të jetë shpjegues apo interpretues i marrëveshjeve që dalin nga dialogu, por vetëm lehtësues i tij.

Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se kjo ka bërë që palët e përfshira në dialog jo rrallë t'i interpretojnë ndryshe nga njëratjetra marrëveshjet dhe të mos pajtohen lidhur me to. Një situatë e tillë, sipas politologut Tahiri, e shpjegon edhe insistimin e autoriteteve të Kosovës për përfshirjen aktive të ShBA-së në dialog, kur tashmë është paralajmëruar se duhet të përmbyllet me një marrëveshje juridikisht obliguese për palët. Por, sipas tij, ky dialog nuk e ka formatin e një konference ndërkombëtare për Kosovën. "Nuk është konferencë ndërkombëtare dhe nuk mund të ketë garantues ndërkombëtar i cili e imponon zbatimin (e marrëveshjes). Duhet të kemi një lloj dialogu apo bashkëbisedimi me Serbinë për pranimin në fund të shtetit të Kosovës. Kosova e ka këtë qëllim dhe proceset nuk kthehen prapa. Me Serbinë do të ishte më mirë që çështjet t'i zgjidhnim ashtu si i zgjidhim me Maqedoninë, me Shqipërinë dhe me të gjitha shtetet e tjera dhe jo të hyjmë në një status të veçantë të bisedimeve që është më pak sesa pozicioni i shtetit të Kosovës", ka deklaruar Tahiri.

Por, analisti Ibrahimi ka theksuar se, në rast se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ligjërisht obliguese, do të interpretohej në dy mënyra, atëherë ajo nuk do të konsiderohej fare si marrëveshje. "Nuk besoj se ky është objektivi i Bashkimit Evropian dhe i Shteteve të Bashkuara. Prandaj, kjo marrëveshje, e cila synohet të arrihet deri në fund të vitit, do të jetë e qartë dhe do të çojë drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Nuk besoj se do të lejohen ambiguitete të tilla. Nuk është në interesin e vendeve që po insistojnë të kemi një zgjidhje në këtë dialog. Kjo marrëveshje do të ketë një garanci qoftë nga Bashkimi Evropian, por edhe nga Shtetet e Bashkuara dhe vendet e fuqishme si Gjermania", është shprehur Ibrahimi.

Sidoqoftë, pavarësisht se në disa raste autoritetet e të dyja vendeve, të Kosovës dhe të Serbisë, kanë deklaruar se një marrëveshje ligjërisht obliguese do të duhej të arrihej deri në fund të këtij viti ose në fillim të vitit të ardhshëm, të dyja palët vazhdojnë të mbajnë qëndrime skajshmërisht të kundërta lidhur me zgjidhjen e problemeve që do të çonin në normalizimin e tërësishëm të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

# KMDLNj-ja ia tregon sfidat drejtorit të ri të Shërbimit Korrektues të Kosovës



PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Përfaqësues të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) kanë realizuar takim me drejtorin e ri të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi.

KMDLNj-ja, në cilësinë e organizatës e cila me vite të tëra monitoron realizimin e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe të stafit korrektues, ka prezantuar një pasqyrë të përgjithshme të Shërbimit Korrektues në përgjithësi, duke treguar edhe sfidat dhe çështjet të cilat kërkojnë të realizohen më shpejt.

Në këtë takim u pajtua se gjendja e përgjithshme në Shërbimin Korrektues të Kosovës është e mirë, por u cekën edhe drejtimet në të cilat ka ngecje.

Drejtori i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, ka mirëpritur të gjitha çështjet e ngritura nga KMDLNj-ja dhe ka kërkuar që organizatat e shoqërisë civile të cilat merren me monitorimin e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria t'i paraqesin rekomandimet dhe të jenë bashkëpunëtore për përmirësimin e gjendjes dhe të kushteve për personat e privuar nga liria dhe për stafin e angazhuar në këtë shërbim. "Për KMDLNj-në paraqet shqetësim numri i madh i atyre që një kohë të gjatë janë ushtrues detyre, infrastruktura rreth Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, vonesa e funksionalizimit të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, që për pasojë shkakton mbipopullimin në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, mossistemimi i të miturve me masë edukative në Qendrën për të Mitur në Lipjan sikur edhe mossigurimi i ushqimit për personat e privuar nga liria në përputhje me nevojat shëndetësore, në mes të tjerash", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së.

(Në 21-vjetorin e rënies të dëshmorit të kombit Luan Haradinaj)

# LUAN HARADINAJ DHE LUFTA ÇLIRIMTARE



**Prof. dr. Emin KABASHI**
*Këshilltar shkencor*
*Instituti Albanologjik i Prishtinës*

## Përkufizimi

Dëshmori i Kombit, Luan Haradinaj, si dhe të gjithë dëshmorët e kombit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me rënien e tyre në altarin e lirisë, njëherë e përgjithmonë kanë mbyllur rrugën që mbi jetën tonë dhe të fëmijëve tanë të mos bie harrimi. Nuk ka asgjë më të kobshme sesa harrimi në jetën e një populli historik, siç është edhe populli shqiptar.

Me luftën e tyre, që është i vetmi veprim historik, duke u bërë bartës të luftës për liri dhe për çlirim, dëshmorët e kombit, në mesin e tyre edhe Luan Haradinaj, janë bërë shenja të kujtesës sonë historike dhe kombëtare. Ata u bënë edhe kuptimi i jetës, edhe kuptimi i vdekjes, u bënë kuptimi i parë i veprimit historik për liri, e cila fitohet vetëm me luftë dhe me gjak.

## Hyrje

Të dhënat sipërfaqësore u folën këtu në fillim të Akademisë përkujtimore, që janë, thuajse vetëm një pjesë e letërnjoftimit të një luftëtari, që janë ana e jashtme e të dhënave jetësore të një dëshmori të kombit. Jetën e tij të brendshme, ëndrrat dhe idealet, luftën e armatosur dhe gatishmërinë për të dhënë çdo gjë për lirinë, nuk janë në jetëshkrimin e tij, as në shënimet që ka botuar Fjalori Enciklopedik Shqiptar, por as në të dhënat që ka ruajtur Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të Kombit të Luftës së UÇK-së.

Ai ishte pjesë e lëvizjes së fshehtë kombëtare, që kur ishte i ri. Ai ishte emëruar Komandant i Logjistikës së UÇK-së, në moshën 20-vjeçare. Por, askush nuk mund t'i përflasë idealet e tij, kur ai nisej për të sulmuar me armë stacionet e policisë pushtuese, apo vendqëndrimet e ushtrisë serbe përgjatë kufirit që ndante tokat shqiptare.

## Ideali i lirisë dhe lufta e armatosur e UÇK-së

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ishte njëra nga ushtritë më të reja, jo vetëm në Evropë por kudo, që kur dihet për historinë e luftërave. Njëri nga këta të rinj, vetëm 20 vjeçar, kur emërohet Komandant i Logjistikës së Luftës së UÇK-së, ishte edhe luftëtari i lirisë, Luan Haradinaj. Çka do të thoshin Akademitë ushtarake, edhe ajo shqiptare në Tiranë, sepse në Prishtinë nuk kishte Akademi të këtillë, ngase ishte e pushtuar, për detyra të këtilla të këtij të riu. Një zot e di, por do të flitej gjerë e gjatë për përgatitjen e tyre profesionale, për njohjet e të gjitha të papriturave të luftës së armikut, për mënyrën e mbrojtjes, si dhe për anën ligjore të sigurimit të armëve për luftën çlirimtare. Të gjitha këto teori, as nuk vlenin për Luan Haradinaj, Komandantin e Logjistikës së UÇK-së, as për ushtarët e tjerë të luftës së UÇK-së, sepse pushtuesi ishte kujdesur që të mos bëhej dije e këtillë, sepse as në Tiranë e as në Prishtinë, nuk kishte mundësi të fitoheshin njohuri sistematike për ligjet e luftës. Do të thotë, ai që nesër pasnesër, mund të shpjegojë mendësinë e këtyre idealeve, për të cilët ka rënë edhe Luan Haradinaj, mund të ketë përparësinë që të kuptojë drejt tharmin e asaj që quhet Luftë e UÇK-së për liri, për çlirim dhe për bashkim kombëtar.

Sot, në 21-vjetorin e rënies së dëshmorit të kombit, Luan Haradinaj, aspak nuk është me rëndësi çka thuhet me fjalorin e politikës së ditës për luftën çlirimtare, as për dëshmorët e kombit, aspak nuk është me rëndësi se çka shkruajnë gazetat e ditës, të porositura, apo të pavarura, siç aspak nuk është me rëndësi se çka thonë ndërkombëtarët dhe një pjesë e shqiptarëve, se a ishte konflikt, apo luftë e armatosur çlirimtare. Pse nuk është me rëndësi, mund të pyes dikush? Nuk është, qoftë edhe për faktin e vetëm se kjo gjuhë, e këtyre niveleve, nuk është e zonja të shpalojë bërthamën e gatishmërisë së sakrificës, deri edhe të jetës, të gjithë atyre të rinjve dhe të rejave, luftëtarë dhe luftëtare të lirisë së kësaj pjese të atdheut tonë. Pa këto ideale dhe pa këtë sakrificë, nuk do të bëhej lufta çlirimtare e UÇK-së, andaj shpjegimi i saj me gjuhën e politikës së ditës, është anakronizëm historik.

Në emër të këtyre idealeve, për të cilët edhe ka rënë në altarin e lirisë, ai është bërë pjesë e veprimit të madh historik, që përveç çlirimit të kësaj pjese të atdheut, ka hapur edhe procesin e madh historik për bashkimin e trojeve shqiptare, edhe sot të copëtuar. Ky ideal dhe ky veprim historik, pjesë e të cilit përjetësisht është edhe dëshmori i kombit Luan Haradinaj, nuk shpjegohet as me fjalimet e politikës së ditës, kudo që bëhet ajo, në Tiranë, në Prishtinë, në Shkup, në Bruksel, apo në Uashington, qoftë edhe vetëm për faktin se këto fjalime harrojnë veprimin e madh historik që ka hapur Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që është bashkimi kombëtar, por nuk shpjegohet drejtë as nga institucionet tona shkencore e arsimore, sepse luftën për liri e kanë parë vetëm në ekranet e televizionit. Bashkimi kombëtar, një ditë do të bëhet realitet historik, me ne, apo pa ne, dhe siç e ka dëshmuar historia jonë, së paku që nga Mesjeta shqiptare e Motit të Madh të Skënderbeut, ky veprim historik nuk do të kishte përmasë kombëtare pa luftën dhe pa rënien e dëshmorëve të kombit të luftës së UÇK-së, në mesin e të cilëve edhe Luan Haradinaj.

Të dhënat e sipërfaqshme të jetës dhe të veprës së një djaloshi 24 vjeçar, që ishte bërë pjesë e rrugës së madhe të lirisë dhe të çlirimit të një pjese të atdheut tonë, e cila ishte e pushtuar, që i paraqiti para jush Profesoresha e nderuar, udhëheqëse e kësaj Akademie përkujtimore, Afërdita Dervishi, dëshmojnë vetëm një fakt: se ai ishte vetëm 24-vjeçar kur bëhet pjesë e kujtesë sonë historike e kombëtare. Pra, ishte një djalë i ri, që nuk pranonte të shihte ëndrra me sy hapur, kur pjesë të atdheut ishin të pushtuara. Kush di të shpërfaqë këtë pjesë të ëndrrave të tyre, të idealeve të tyre, ai ose ajo, mund ta shpjegojë idealin e lirisë në emër të të cilit ka rënë dëshmorët e kombit, në mesin e tyre edhe Laun Haradinaj, mund të mendojë se ka arritur të shpjegojë bashkëjetesën e këtyre dy idealeve: të lirisë dhe të dashurisë ndaj atdheut.

Djem të këtillë dhe vajza të këtilla, trima të këtillë dhe trimëresha të këtilla, asnjëherë nuk i kanë munguar tokës shqiptare, siç nuk i kanë munguar kësaj toke as familje me shenjë, që kanë marrë barrën për t'u bërë pjesë e veprimit historik që kërkonte koha.

Këto familje të mëdha janë bërë të tilla, ngase kanë pasur mbështetjen e madhe të të gjithë qytetarëve liridashës, janë bërë Vatra dhe Streha, do të thoshte Prof. Çabej ynë i madh, e të gjithë atyre që ishin të gatshëm të luftonin për liri.

Populli shqiptar, si një popull historik, asnjëherë nuk i kanë munguar familjet e mëdha, që janë bërë shenjë e jetës historike të popullit, nuk i kanë munguar ushtarët dhe gjeneralët e lirisë, nuk i kanë munguar të rënët për liri dhe ata që do të vazhdojnë rrugën e dëshmorëve të kombit, nëse liria e tokave shqiptare nuk do të jetë e përmasës së plotë historike.

## Rënia e Luan Haradinajt është tharmi i lirisë së atdheut

dëshmori i kombit, Luan Haradinaj e dinte se në luftë, edhe vritet luftëtari, së pari, pastaj njerëzit kudo që përballen me pushtuesin. Prandaj, që liria të kishte fytyrë njeriu, duhej rënia e tij, edhe në atë moshë, sepse dëshmorët e kombit nuk kanë as pleqëri, as vdekje. Jeta e dëshmorëve të kombit është e përjetshme, siç është i përjetshëm ideali i lirisë. Kush di ta shqyrtojë, ta analizojë dhe ta shpjegojë, këtë marrëdhënie në mes idealit të përjetshëm të lirisë dhe idealit të sakrificës në emër të saj, siç është sakrifikuar edhe dëshmori i kombit, Luan Haradinaj, mund të mendojë se i është afruar përkufizimit real, të kuptueshëm të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesë e secilës ishte edhe Luan Haradinaj,



bashkë me të gjithë anëtarët e familjes, bashkë me të gjithë bashkëluftëtarët, por përjetësisht bashkë me të gjithë dëshmorët e kombit.

Kur koha thirri në luftën për liri, të cilën e kishin përgatitur breza të shqiptarëve idealistë dhe të ditur, Luan Haradinaj, kishte edhe në familjen e tij, frymëzues të tillë, idealistë të tillë, që ia kishin mësuar alfabetin e luftës për liri.

Kurdo që shkoni në Gllogjanin e sotëm, në vendlindjen e Luan Haradinajt, si dhe në shumë Gllogjan të tjerë, do të shihni kullat në të cilat janë rritur dhe edukuar luftëtarët e ardhshëm të lirisë, ushtarë dhe ushtaret e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sa kot, sot flitet e bëhet, thuajse, zhurmë kalamajsh, kush ishte i pari, apo kush ishte i fundit në luftë, cilit krahë, apo cilit organizim i kishin takuar, kujt i kanë dhënë, apo kujt nuk i kanë dhënë llogari, e llafomani të ngjashme, sepse në këto çaste, harrohet mençuria e këtij populli, e cila thotë: pas luftës, përherë ka më shumë komandantë se sa ushtarë!

Pra, kurdo që shkoni sot në vendlindjen e Luan Haradinajt, në përfytyrimin e fillimeve të luftës çlirimtare, do t'u dalë dilema: Çka ishin këto, kulla apo kala? Në themelet e këtyre kullave, në gjakun e këtyre familjeve, që po bëheshin një shenjë e re e kujtesës sonë historike, ishin ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, luftëtarët e lirisë, nga më i moshuari e deri te më i riu, që ende nuk i kishte vënë brisk fytyrës, nga nëna e familjes e te motra, që luftonin për tokat e copëtuar dhe të përgjakura të atdheut. Në këtë luftë për liri, kishte edhe vdekje, pra kishte rënie për lirinë e atdheut, jo vetëm për t'i dhënë kuptim lirisë dhe jetës së atyre që vijnë pas, por edhe për ta përmbysur padrejtësinë historike që kishte rënë mbi jetën historike të shqiptarëve shumë herë nëpër shekuj.

Në jetën tonë dhe në jetën e brezave që do të vijnë, ata që po bëjnë kujtesën historike të shqiptarëve kudo që janë, dëshmorët e kombit, njëri nga ta, edhe Luan Haradinaj, do të kujtohen për përmasën e lirisë që kanë krijuar, për dinjitetin që na kanë vënë në vend, për veprimin historik që kanë bërë duke e luftuar okupuesin e tokave tona. Do të kujtohen edhe për mbrojtjen e jetëve tona dhe të fëmijëve tanë, si atë ditë kur fëmijët e shkollës fillore të Gllogjanit ishin zënë robër nga forcat ushtarake dhe policore serbe.

Pra, bashkë me ta, do të kujtohet 5 e 7 marsi i Prekazit të Komandantit Legjendar, Adem Jasharit, do të kujtohet 24 marsi i vitit 1998 dhe lufta heroike e dëshmorëve dhe e luftëtarëve të familjes Haradinaj dhe e të gjitha familjeve të Glogjanit, si një fitore e madhe e lirisë, si një fitore e madhe e të drejtës për të jetuar, por, në fund të fundit, si një fitore e madhe e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

## Përfundim

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, as nuk erdhi nga qielli, as nuk mbiu nga toka, as nuk e bënë të huajt. Atë e organizuan, e bënë dhe e fituan djemtë më të mirë dhe vajzat më të përbetuara për lirinë e Kosovës. Në mesin e tyre, ndër të parë, ishte edhe luftëtari i lirisë, Luan Haradinaj, rënia e të cilit ishte njëra nga humbjet më të madha të fillimeve të luftës së armatosur të UÇK-së. Ata pra, dëshmorët e kombit, që lirisë së Kosovës dhe ardhmërisë së tokave shqiptare ia falën jetën, plagët, gjaqet, dasmat, por ia falen edhe rëniet.

Djemtë dhe vajzat e lirisë, secili më idealist se tjetri, vinin në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare për të vënë shenjat e kujtesës historike të shqiptarëve në vend, ngase armiqtë tanë kishin nëpërkëmbur edhe shenjat më të shenjta - tokën e atdheut dhe lirinë tonë. Të këtillë ishin edhe luftëtarët që i sillte në fronte e luftimeve Luan Haradinaj, për të rënë vetë i pari, që të bëhej shenjë e frymëzim për armatën e madhe të luftës për liri.

Ata do të vijnë sërish e sërish, sa herë Atdheu do të jetë në rrezik, në Prekaz e në Gllogjan, në Dukagjin e në Drenicë, në Llap e në Shalë të Bjagorës, në Hotel e në Mateç të Kumanovës, në Tetovë e në Gostivar, ku ka rënë komandanti i tri ushtrive çlirimtare, Tahir Sinani. Ata do të vijnë, bashkë me Luan Haradinajn, në tërë gjeografinë kombëtare, kudo dhe kurdo që thërret zëri i lirisë. Kurse nënat nuk i vajtojnë dëshmorët, sepse kanë rënë për lirinë tonë dhe për lirinë e atyre që do të rriten në liri.

**Prishtinë, më 6 maj 2018**

Mbahet në Prishtinë konferenca "Sektori minerar dhe resurset minerale Kosovë - Shqipëri"

# Limaj: Rritja e investimeve në sektorin mineral zhvillon ekonominë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ




PRISHTINË, 16 MAJ - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka thënë se Zoti e ka bekuar Kosovën me pasuri natyrore dhe ajo nuk do të jetë barrë e ndokujt. Këtë qëndrim Limaj e ka dhënë të mërkurën në konferencën "Sektori minerar dhe resurset minerale Kosovë - Shqipëri" e cila është mbajtur në Prishtinë. Limaj ka thënë se organizimi i kësaj konference është i mirëseardhur pasi i kontribuon fuqizimit të bashkëpunimit Kosovë - Shqipëri.

Zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim del që vlera e mineraleve të Kosovës vlerësohet prej 12.5 deri në 25 miliardë eurosh. "Andaj rritja e investimeve në sektorin mineral dhe të ardhurat shtesë në sektorin e industrisë do të mundësojnë normë më të lartë të rritjes ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe social", ka thënë ai.

Limaj ka theksuar se prioritet i Qeverisë së Republikës së Kosovës është rritja e zhvillimit ekonomik. "Ne nuk do të ndalemi dhe do t'i ndërmarrim të gjitha veprimet e nevojshme të cilat çojnë në zhvillim më të hovshëm. Porosia jonë për ata që nuk e njohin Kosovën është: Ju ende nuk i njihni mundësitë tona. Ne na ka bekuar Zoti me pasuritë natyrore që na ka dhënë dhe nuk do të jemi barrë e ndokujt", ka thënë Limaj.

Kurse ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, ka treguar për përparësitë që i ofron Ligji për Investime strategjike për investitorët në fushën e minierave.

> Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se, sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, vlera e mineraleve të Kosovës vlerësohet prej 12.5 deri në 25 miliardë eurosh. Ai ka theksuar se rritja e investimeve në sektorin mineral dhe të ardhurat shtesë në sektorin e industrisë do të mundësojnë normë më të lartë të rritjes ekonomike dhe zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe social

Ministri Hasani ka theksuar se Kosova është në fazën më të mirë që mund të investohet, duke përmendur shumë faktorë që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së të bërit biznes. "Për rëndësinë e sektorit minerar flet organizimi i kësaj konference. Ne kemi qenë në kontakt me organizatorët e kësaj konference dhe e kemi përkrahur fuqishëm një organizim të tillë, sepse mendojmë se Kosova është në fazën më të mirë për të bërë investime, sidomos në fushën e minierave, për arsye se Kosova ka pasuri nëntokësore që mund të shfrytëzohen", ka thënë Hasani. Ai ka pohuar se janë përcaktuar 11 zona të interesit të veçantë ku mund të kërkohet për minerale e që, sipas tij, rruga më e mirë për investitorët është Ligji për Investime Strategjike.

Ministri Bajram Hasani ka thënë se viti 2018 do të jetë vit i investimeve sepse, sipas tij, janë krijuar të gjitha parakushtet. "Vlen të theksohet se edhe sa i përket infrastrukturës rrugore jemi mirë për shkak se janë ndërtuar autostrada dhe ato krijojnë lehtësira për bizneset. Të gjitha këto janë parakushte për të ardhur investitorët e huaj që ta shohin Kosovën një treg ideal. Presim që ky vit të jetë vit i shpresës, vit i investimeve", ka thënë ministri Hasani.

Ndërkaq ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka thënë se sektori i minierave dhe mineraleve ka ngecur si pasojë e disa ngatërresave burokratike. Sipas tij, këto ngatërresa po mënjanohen përmes Ligjit për Investime Strategjike dhe atij për Miniera dhe Minerale.

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, ka thënë se Shqipëria duhet ta ndihmojë Kosovën në zhvillimin e sektorit minerar. "Kosova hyri në dekadën e dytë të pavarësisë dhe është bërë pak në zbulimin e shfrytëzimit të mineraleve. Nuk na pengon asgjë për ta nxitur këtë bashkëpunim me përvojat e duhura, në mënyrë që ta krijojmë një hartë të rëndësishme për ta paraqitur para investitorëve potencialë. Ne jemi dy tregje të vogla, por ky treg mund të zgjerohet me punën tonë të përbashkët..Unë do të apeloja të krijohet një komision i përbashkët ad-hoc, i cili do të përgatiste një projekt për t'ua paraqitur dy qeverive", ka deklaruar Minxhozi.

Në këtë konferencë ka folur edhe zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, Enis Aliko, i cili ka thënë se ky sektor në vendin e tyre është i privatizuar dhe operojnë vetëm subjektet private. "Sot Qeveria shqiptare inkurajon në nxitjen e investimeve. Siguria në punë është një nga problemet që ne po shikojmë në sektorin e minierave në Shqipëri", ka thënë Aliko.

# Fillon zbatimi i pagesave online për policat kufitare



PRISHTINË, 16 MAJ (ER) - Kryesuesi i Asamblesë së Përgjithshme të Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Rrahim Pacolli, ka bërë me dije se nga sot (e enjte) do të nisë zbatimi i projektit të pagesave online të policave kufitare. "Nga 17. 5. 2018 fillon zbatimi i projektit të pagesave online të policave kufitare, i cili ka ardhur si domosdoshmëri e përshtatjes së nevojave të tregut me përparimet teknologjike dhe standardet e avancuara bashkëkohore për pagesat e policave online. Kjo do të krijojë lehtësira të mëdha në radhë të parë për bashkëkombësit tanë, por edhe për të gjithë të interesuarit e tjerë. Përfitimi kryesor i këtij projekti do të jetë shkurtimi i kohës së pritjes në kufi dhe, rrjedhimisht, kohëzgjatja e udhëtimit me destinacion Kosovën", ka thënë Pacolli. Për jetësimin e këtij projekti ai ka falënderuar ish-ministrin e Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, koordinatorin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Gani Thaçin, drejtorin e Përgjithshëm të Byrosë Kosovare të Sigurimeve, Blerim Pushkollin, si dhe ministrat Bejtush Gashi dhe Dardan Gashi.

Rrahim Pacolli i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës t'i lirojë nga pagesa e policave të sigurimeve kufitare të gjitha automjetet private të bashkatdhetarëve tanë nga diaspora, duke marrë përsipër kështu mbulimin e shpenzimeve të policave kufitare. "Kjo do ta zgjidhte njëherë e përgjithmonë problemin e tyre rreth pagesave të policave kufitare dhe do të prodhonte efekte pozitive në kuptim të rritjes së numrit të vizitoreve dhe rritjes së qarkullimit ekonomik", ka deklaruar Pacolli.

# Dy intervista nga dy pehlivanë, njëri me shajkaqë, tjetri me 'xhamadan'!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Të gjithë sillemi si të verbër dhe të shurdhër sepse ashtu duam të jetë: Kosova ka shumë probleme, të natyrës materiale, sidomos të asaj morale. Se ku jemi tash, më së miri tregon fakti se për 300 vende pune në Policinë e Kosovës kanë konkurruar afërsisht 18 000 kandidatë, shumica e të cilëve, po të kishin mundësi tjetër punësimi, Policia e Kosovës do të ishte adresa e fundit ku do të bënin përpjekje ta ndërtonin ardhmërinë. Nepotizmi grykës, klientelizmi partiak, provincializmi primitiv dhe injoranca funksionale, sidomos korrupsioni material dhe jomaterial, e kanë sjellë Kosovën në këtë gjendje ku të gjitha pasojat janë kalimtare dhe të shërueshme, përveç humbja e ardhmërisë për gjeneratat e reja. Degradimi profesional është binjak siamez i degradimit moral që e zvetënojnë edhe ëndrrën më optimiste dhe, në kushte përafërsisht normale, lehtësisht të realizueshme. Nëse e bëni një skenim sipërfaqësor të përbërjes së institucioneve vitale për interesin e shtetit dhe të popullit atëherë nuk mund të pritni shërbime më të mira sesa që i kemi sot, në arsim, shëndetësi, ekonomi, kulturë dhe segmente të tjera. Nëse analizoni ndërmarrjet e mëdha, dikur fitimprurëse, përbërjen e bordeve e sidomos mënyra si emërohen drejtuesit (konkursi është formal), atëherë nuk është e rastit që buxheti i tyre si dhe afarizmi është më i vogël se i rrjetit të organizuar dhe kriminal të lypësve nga Shqipëria. Më të shkathët dhe më kreativë po tregohen drejtuesit e këtij krimi të organizuar të lypsarëve sesa drejtuesit e ndërmarrjeve në Kosovë, të cilat, të jemi të sinqertë, funksionojnë sipas së njëjtës skemë, sipas skenës së krimit të organizuar. Nuk ka vend në rajon që në mënyrë aq të pamëshirshme e ka shkërdhyer pasurinë e shtetit (shtetit!!!!), sikur Kosova përmes një procesi 100 % kriminal të privatizimit. Nuk ka vend në rajon që e ka shkatërruar aq shumë mjedisin përmes ndërveprimit kriminal me kompanitë e huaja sikur që është bërë me kompaninë "Bechtel Enka" e që ka shkaktuar gjenocid në luginën e Grykës së Kaçanikut sikur edhe me ndërtimin e hidrocentraleve në një vend ku ka mungesë të madhe të ujërave. Nuk ka vend tjetër në botë ku një metër e ndërtimit të autoudhëve është më i kushtueshëm se po të shtrohej me metale të çmuara e jo me një petë asfalti të trashësisë së një lakrori e që shembet ende pa u përuruar! Problem e keni ta gjeni një vend, përveç se ku morali është i shtrirë përtokë, ku të dënuarit për krime të rënda largohen nga Kosova, pa u penguar fare apo edhe me ndihmën e atyre që janë përgjegjës për arrestim e pas një kohe kthehen në Kosovë, si heronj të turpit dhe ligësisë sikur që u kthye "Hajnesha në Fron" (simbol i Prishtinës), e cila u pritë me tupanë dhe muzikë sikur të ishte në Klinikën e Gjinekologjisë ku, pas 15 vajzave ka lindë një djalë të hasretit. Apo, rasti tjetër kur një "ish-komandant" i qytetit të palmave, i dënuar për një vepër të rëndë penale dhe i cili, duke i shfrytëzuar lidhjet politike dhe partiake, në vend se të shkojë atje ku e ka vendin, në burg, u arratisë në një shtet ku demokracia është alfa dhe omega dhe tash, për dikë kjo llogaritet si fitore e që është ligësi dhe dhunim i pashpjegueshëm dhe i palejueshëm i ligjit e që, me siguri, nga të njëjtit do të pritet si hero në vend që, nëse nuk mund të dërgohet në burg atëherë duhet të injorohet dhe në këtë mënyrë të bëhet një distancim i qartë nga krimi i pandëshkuar.

Nuk e di nëse ka një vend në botë ku vlerat e mirëfillta njerëzore, kombëtare, politike, morale dhe shtetërore shpërfillen deri në atë masë sikur që ndodhë në Kosovë në favor të antivlerave e që, për ma keq kanë kontribuar në arrestimin dhe ndjekjen e këtyre vlerave sikur që është rasti me bacën Adem Demaçi dhe kryesakrifikuesin Adem Jashari. I pari është lënë krejtësisht në harresë dhe kujtohet apo më mirë ta them keqpërdoret në data të caktuara. Në Prishtinë ka vend për të gjithë, kryesisht për antivlera kurse nuk ka vend për Adem Jasharin sepse ata që e vendosin për këtë, duke ikur nga realiteti, madhështinë e Adem Jasharit mundohen ta marrin për vete e që i bie sikur kur qeni mbështillet me lëkurën e luanit. Bashkëluftëtarët e Adem Jasharit u vranë ose sot janë në margjina kurse ata horrat që nuk e deshën komandantin legjendar sot e përbëjnë "armatën e shpërdoruesve prej 50 000 ushtarëve" e që realisht nuk ishin më shumë se 15 000.

Nuk ka vend në botë ku ata që e sabotuan luftën (përjashtuar rasteve të veçanta) dhe që u distancuan nga kjo luftë duke e denoncuar atë, sot bëjnë përpjekje idioteske ta përvetësojnë këtë luftë!

Gjithashtu, nuk ka vend në botë ku fondet në emër të luftës janë keqpërdorur aq shumë sa në Kosovë dhe se askush nuk i është nënshtruar përgjegjësisë.

Nuk e besoj se ka vend në botë ku udbashët dhe bijtë e tyre trajtohen më mirë se në Kosovë dhe se ku ata që janë sakrifikuar për këtë vend trajtohen më keq. Po e keqpërdori rastin tim; dëshmitari kryesor kur jemi dënuar 8 shqiptarë në Gjykatën Ushtarake në Zagreb, në një proces të montuar politik (jam dënuar me 12 vjet burgim) ka qenë shqiptar, deri vonë, nuk e di nëse ende është anëtar i devotshëm i PDK-së dhe shef i shtabit zgjedhor në një rajon të caktuar të Kosovës. Hetuesi kryesor në Burgun Ushtarak në Zagreb ka qenë shqiptar, një kohë sekretar i një ministrie në Kosovë sikur që hetuesi dhe denoncuesi i shumë ushtarëve të arrestuar dhe dënuar shqiptarë, më vonë është shpallur Hero i Kosovës. Për këtë që e them kam aktgjykimin dhe procesverbalet nga hetimet në burgun Ushtarak si dhe të shokëve të tjerë. Nëse këta që i përmenda, pa emër, mendojnë se nuk kam të drejtë, ndonëse nuk kam qenë më parë i vullnetshëm, jo për ta por për fëmijët e tyre sepse këta nuk kanë përgjegjësi për veprimet e prindërve, mund t'i bëjë publike dokumentet ku më →

# Lluka në Sofje: Tregu i përbashkët energjetik mbetet sfida kryesore

Sofje, 16 maj (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZhE), Valdrin Lluka, po merr pjesë në forumin e parë në Sofje me temë "Perspektiva e investimeve". Në këtë forum ministri Lluka, bashkë me homologët e rajonit, kanë diskutuar për rëndësinë e bashkëpunimit drejt zhvillimit të rajonit. "Kosova, duke qenë në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ka luajtur rol kryesor në lidhjen në mes të vendeve. Investimet në infrastrukturë rrugore, hekurudhore dhe tash në telekomunikacion që Kosova ka realizuar dhe është duke realizuar, e bëjnë rajonin më të ndërlidhur dhe më atraktiv për investime të huaja", ka thënë Lluka. Gjithashtu, Lluka para shumë bizneseve të huaja që ishin të pranishme ka prezantuar mundësitë që Kosova ofron në sektorë të ndryshëm, me fokus në energji, miniera dhe teknologji informative. Sipas tij, integrimi i një tregu të përbashkët energjetik mbetet sfida kryesore në vend.



mbështesin 100 % për atë që e shkruaj. Vëllai i një këshilltari të kryeministrave dhe kullotës i thuaja të gjitha grazhdeve të udhëheqësve dhe fondeve të pasluftës, gjatë një viti, në Burgun e Mitrovicës e ka torturuar, si të burgosur politike, Fexhrie Bilallin, tash Shala, gruan time dhe kurrë nuk e kam bërë publike! Denoncuesit dhe diferencuesit tanë kryesorë pasi kemi dalë nga burgu kanë qenë disa bastardë të LDK-së të cilët kanë pasur poste të mirëpaguara dhe kanë mbijetuar për mrekulli në këtë ligatinën morale e quajtur Kosovë. Fëmijët e tyre bëhen ambasadorë, këshilltarë, ministra apo bartës të posteve që nuk paguhen nga buxheti i Kosovës, kurse fëmijët tanë i skuqin sytë kur kërkojnë para nga prindërit.
Nuk ka vend në botë ku ndërmarrja që është para falimentimit, me urdhër politik, punëson, pa konkurs brenda ditës 70 punëtorë të pakualifikuar, për vende të kualifikuara apo ku, gjithashtu një përfitues, shpërdorues 100 % i buxhetit të Kosovës, brenda ditës punëson 17-20 punëtorë, pa konkurs dhe pa pasur nevojë duke e mbipopulluar edhe më shumë një shtëpi publike që nuk ofron cilësi as përsëafërmi sa ofron një shtëpi publike mesatare në shtetet perëndimore. Edhe kjo e jona e ka statusin e shtëpisë publike.
Sot në Kosovë e keni të pamundur, sado i aftë që të jeni, ta siguroni një vend pune apo biznes në përputhje me kualifikimin dhe zotësinë që e keni nëse nuk jeni ofrues i shërbimeve orale (gojëtar) i një udhëheqësi politik, nuk jeni nga rrethi i tij familjar, nuk i shërbeni qençe partisë së liderit, nuk jeni në marrëdhënie ortakërie apo që nuk e përkrahni politikisht në momentet vendimtare. Për para nuk ka problem se kanë bërë edhe për pasardhësit që do të jetojnë në planetin Mars. Nuk ka vend në botë që fitoren me aq shumë sakrifica për më shumë se 100 vjet, e kanë vënë peng të një bastore politike ku, Serbia, pa asnjë investim po bëhet vendimmarrës për çështjet që janë ekskluzivisht çështje e brendshme e një shteti dhe se asnjë vend normal nuk do ta lejonte dhe pranonte këtë përjashtuar disa negociatorëve të tredhur nga çdo përgjegjësi dhe të shquar për grykësi materiale dhe grykësi për famë e që e kanë futur Kosovën në rrugë pa krye apo në rrugë njëkahore drejt Serbisë (varshmërisë nga Serbia). Tërë këtë hyrje të gjatë e bëra për këtë konstatim të fundit sikur edhe për ta arsyetuar titullin. Në fakt, mbrëmë në dy televizionet (KTV dhe Klan Kosova), thuaja në të njëjtën kohë ishin dy intervista e që flisnin për gjëra thuaja të njëjta. Këto intervista kishin personazhe dy personalitete të ndryshme, Aleksandar Vuçiqin, ish-paramilitarin e Sheshelit dhe paramilitarin aktual të Serbisë, ndryshe president i Serbisë, mashtrues ordiner i cili, nën petkun e demokratit përpiqej të dëshmonte se është për zgjidhje të çështjes së Kosovës duke ofruar "fakte" se Serbia dhe vet ai po bëjnë sakrifica të dhimbshme për të gjetur një zgjidhje të pranueshme. Realisht, tërë kohën ky mashtrues dhe ishkriminel potencial lufte fliste se si serbët e Kosovës kanë marrë pjesë në zgjedhje lokale dhe parlamentare në Kosovë, se si serbët janë angazhuar në Policinë e Kosovës, si gjykatësit dhe prokurorët serbë të Kosovës po punojnë në institucionet e Kosovës dhe për pallavra të tjera që janë çështje 100 % të brendshme të një shteti të pavarur dhe sovran. Linte përshtypje sikur shqiptarët kanë bërë krime ndaj serbëve më shumë se 100 vjet dhe se lufta e fundit është zhvilluar në Serbi, se viktimat e luftës janë vetëm serbë, se janë dhunuar vetëm femrat serbe dhe se Serbia nuk ka nevojë për kërkimfalje duke menduar se shqiptarët duhet të kërkojnë falje për krimet që i kanë bërë serbët ndaj shqiptarëve!!! Gazetari që e ka trashëguar një emër të madh dhe të lavdishëm por që emrin e ka ndërruar, Idriz (Idro) Seferi, u palua para këtij mashtruesi, shokut të Hashimit, sikur vejushat e Gostivarit. Në këtë intervistë, Vuçiqi organizoi orgji orale kundër shqiptarëve dhe Kosovës duke e hequr çdo përgjegjësi nga Serbia dhe duke e fajësuar rëndë Kosovën. Vuçiqi doli fitues në përballje me një që i mungon guximi dhe që ka mungesë të krenarisë ndryshe, me një gazetar të zoti që i ka të gjitha faktet e mundshme, Aleksandar Vuçiqi do të ndahej i lagur. Aleksandar Vuçiqi e akuzoi Kosovën për mospërmbushje të marrëveshjeve të nënshkruara në kohën kur e pengon Kosovën të anëtarësohet edhe në organizatat krejtësisht të parëndësishme. Ai tha se ka luajtur shah me Gërxhaliun e tash po luan koqe me Hashimin sepse nuk po ia hapë telefonin pas trajtimit si qen të Marko Gjuriqit duke mos treguar se pikërisht Vuçiqi ia ndau rolin e qenit Marko Gjuriqit duke e dërguar pa leje në Kosovë, kurse Markoja, për shkak të popullaritetit kishte dëshirë të trajtohej siç u trajtua. Realisht këtu politikisht përfituan dyshja Vuçiq dhe Thaçi, kurse Markoja ishte kone teatrale e këtyre dy mashtruesve.
Në intervistën tjetër në KTV, njëri ndër politikanët e rrallë kosovar që merr vesh shkrim - lexim nga politika dhe që lexon madje edhe libra, Hajredin Kuçi, midis rreshtave bëri me dije se Kosova do të ketë shumë probleme por se nuk ka çka të brengoset shkaku se nuk mund të dëmtohet derisa e ka president dhe udhëheqës të bisedimeve Hashim Thaçin kurse, unë nuk e di se ç'duhet të bëhet veç asaj që e ka bërë Hashimi me Zezditën dhe kondomët shëtitës të Hashimit e të konsiderohet si dëmtim të interesave të Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Kosovës e shpalli patriot Hashimin sepse një Gjykatë që e nxjerr formulimin më idiotesk të mundshëm sikur kjo gjykatë që e nxori për Asociacionin, nuk pritej të nxjerr vendime më të mira kurse, sa i përket nivelit profesional, më profesional ka qenë Gjykata Komunale në çdo vend të Kosovës para lufte, me porotë që i ka mbledhë në rrugë se kjo Gjykatë që është thuaja analfabete në marrje të vendimeve dhe e cila merr vendime nën ndikim të politikës sepse edhe janë të emëruar politikisht. Nuk është aty më Enver Hasani, spiritus movens i vendimeve të mëdha dhe të guximshme i cili, përkundër fjalorit mospërputhës me të një intelektuali, në planin e dijes është Ajnshtajn për këta bishta të politikës që edhe as një minutë të vetëm nuk e kanë shpenzuar për drejtësi. Enver Hasani, në aspektin e dijes intelektuale është mbi të gjithë këta dhe më vjen mirë që është liruar nga akuza për të cilën kurrë nuk kam besuar se ka përgjegjësi. Enver Hasani është intelektual i shkëlqyer por si udhëheqës dhe organizator është katastrofal. Hajredini ka vendosur të kthehet në politikë mirëpo nëse e përdorë Hashimin si referencë, më mirë të largohet përfundimisht nga politika, të lexojë libra, ta rrisë djalin dhe të shkruaj diçka të mençur. Apo, të bëhet avokat ku do të ishte i shkëlqyer. Në vendet e vërteta ku ka intelektualë të vërtetë, asnjë intelektual i vërtetë nuk i nënshtrohet injorancës së të "madhërishmëve" të politikës.
Tri këshillat e peshkut të artë: Për t'i shpëtuar luspat dhe kokën pa tru, peshku i artë i dha tri këshilla Danit, peshkatar i rryer, me përvojë dhe mungesë të mëshirës:
1. Duhet të jesh qen i Shpend Ahmetit sepse do të trajtohesh si lopët e Indisë, si diçka me vlerë dhe e shenjt. Shpend Ahmeti e ka shndërruar qendrën dhe sheshet e Prishtinës në strehimore dhe vendqëndrim të qenve dhe të cilët nuk i pengon askush. Shpendi ua ka vendosur qenve nga një shenj identifikimi në vesh dhe ata qëndrojnë tërë ditën e lume në vendet më frekuentuese të qytetit. Polici, këmbë, me biçikletë apo skuter, për gabimin më të vogël ta shqipton gjobën që ndikon edhe në palcën kurrizore kurse qentë e Shpendit nuk guxon askush t'i bëjë nervoz. Ata
(qentë) mund edhe ta kafshojnë ndonjë kalimtar, sa për të mbajtur dhëmbët në formë, por askush nuk merret me ta. Nëse vazhdon rritja e numrit të qenve me këtë përparim, Shpendi përfundimisht do të bëhet kryetar i qenve!
2. Të jesh kondom, i afërt se Hashimi nuk ka shokë, i presidentit post-historik. Përveç se ke mbrojtje dhe mirëqenie materiale do ta krijosh një gjendje që askush nuk do të dojë përveç Daçiqit dhe Vuçiqit. Pa problem do të bëhesh deputetë, ministër, ambasador apo do ta fitosh ndonjë terminal. Thjesht, Hashimi është Hashim. Është mbi Kushtetutën.
3. Të jesh serb i Kosovës dhe shtetas i Serbisë. Jeton në Kosovë, vendin e punës e ke në Kosovë, merr pagë nga Kosova, nuk e pranon Kosovën dhe punon për Serbinë! Vjedh dhe bënë ç'të duash dhe askush nuk ta prishë tymin e duhanit apo të temjanit.
Të gjithë besimtarëve të besimit islam ua uroj muajin e bekuar të Ramazanit, agjërim të lehtë dhe që pranohet nga Krijuesi Ynë.

# Sot lansohet Fondi për Inovacion dhe Ndërmarrësi



**Prishtinë, 16 maj (ER)** - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në kuadër të angazhimeve në përkrahje të inovacionit dhe ndërmarrësisë sot (e enjte) nga ora 11:00 në hotel "Swiss Diamond" në Prishtinë lanson "Fondin për Inovacion dhe Ndërmarrësi" për organizatat joqeveritare, që fushë të veprimtarisë së tyre e kanë inovacionin. Kjo ngjarje pritet të mbledhë përfaqësues të komunitetit të inovacionit dhe ndërmarrësisë, të cilët do të informohen me mënyrën e përfitimit të fondeve nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, me anë të projekteve të tyre që për qëllim kanë promovimin e zhvillimit të inovacionit dhe ndërmarrësisë.
Në këtë ngjarje, përveç ministrit Beqaj, pjesëmarrësve do t'u drejtohen edhe ministri Bedri Hamza, përfaqësues nga STKK dhe KIESA.

## Gjermania e përkushtuar të qëndrojë në paktin bërthamor



BERLIN, 16 MAJ - Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, ka thënë se anulimi i marrëveshjes bërthamore në mes të Iranit dhe fuqive botërore do të ishte gabim. Merkeli i ka thënë Parlamentit gjerman se, pavarësisht se pakti është "larg ideales, nuk është në rregull që kjo marrëveshje të anulohet në një situatë të tillë". Ajo ka thënë se, pavarësisht prej mospajtimeve në mes të Uashingtonit dhe aleatëve evropianë mbi këtë marrëveshje, "marrëdhëniet transatlantike janë dhe mbeten të një rëndësie të madhe".
Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka njoftuar javën e kaluar se ShBA-ja tërhiqet nga marrëveshja, pavarësisht prej përpjekjeve të fuqive evropiane për ta bindur Uashingtonin që të qëndrojë në këtë pakt.
Më 2015 Irani kishte nënshkruar marrëveshjen bërthamore me Shtetet e Bashkuara, Britaninë, Francën, Gjermaninë, Rusinë dhe Kinën. Kjo marrëveshje e obligon Teheranin ta frenojë programin e tij bërthamor në këmbim të lehtësimit të sanksioneve.

# Pheniani kërcënon me pezullim të takimit me presidentin Trump

Zëvendësministri i parë i punëve të Jashtme të Koresë Veriore, Kim Kye Gwan, tha se Pheniani do të detyrohet të rishqyrtojë nëse do të marrë pjesë në takimin e 12 qershorit në Singapor, nëse ShBA-ja vazhdon të kërkojë që regjimi njëanshëm t'i braktisë armët e tij bërthamore





PHENIAN, 16 MAJ - Koreja e Veriut kërcënoi me tërheqje nga takimi i planifikuar për muajin e ardhshëm ndërmjet udhëheqësit të saj Kim Jong Un dhe presidentit amerikan, Donald Trump. Në një deklaratë të transmetuar të mërkurën nga agjencia shtetërore e lajmeve KCNA, zëvendësministri i parë i punëve të Jashtme, Kim Kye Gwan, tha se Pheniani do të detyrohet të "rishqyrtojë" nëse do të marrë pjesë në takimin e 12 qershorit në Singapor, nëse Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të kërkojnë që regjimi njëanshëm t'i braktisë armët e tij bërthamore.
Kimi tha se Koreja e Veriut nuk do të jetë e interesuar për takimin nëse Uashingtoni provon "të na shtyjë njëanshëm në qoshe dhe na detyron të heqim dorë nga armët bërthamore". Deklarata është veprimi i fundit i Koresë së Veriut në 24 orën që duket se po fundos periudhën e shtendosjeve në gadishullin korean.
Bisedimet e nivelit të lartë të planifikuara për të mërkurën me Korenë e Jugut u anuluan papritmas nga Pheniani, i cili iu referua stërvitjeve aktuale të përbashkëta ushtarake të Shteteve të Bashkuara me Korenë e Jugut. KCNA tha se stërvitjet Max Thunder janë një provë për pushtimin e Koresë së Veriut dhe një provokim. Deklarata paralajmëron edhe Shtetet e Bashkuara që duhet të jenë të kujdesshme rreth fatit të takimit të planifikuar në dritën e këtyre stërvitjeve provokuese ushtarake të përbashkëta me autoritetet e Koresë së Jugut.
Shtëpia e Bardhë ishte e rezervuar, përveç që tha se do të vazhdojë të bashkërendojë ngushtë me aleatët e saj.
Pentagoni e përshkroi stërvitjen Max Thunder si një stërvitje të zakonshme vjetore ndërmjet Koresë së Jugut dhe Shteteve të Bashkuara.
Zëdhënësja e Departamentit amerikan të Shtetit, Heather Nauert, nënvizoi se Kimi ka thënë se e kupton dhe vlerëson rëndësinë e stërvitjeve të tilla për Shtetet e Bashkuara. Ajo tha se Shtetet e Bashkuara do t'i vazhdojnë planet për takimin me Kim Jong Un.
Por, ata që kanë punuar ngushtë me Korenë e Veriut, thonë se ka pjesëtarë të vijës së fortë që duan t'i sabotojnë negociatat diplomatike që ata besojnë se mund ta rrezikojnë dinastinë Kim. Seuli tha të mërkurën se bisedimet ndërmjet Veriut dhe Jugut do të përqendroheshin në planet për çmilitarizim dhe për t'i dhënë fund edhe formalisht luftës së Koresë.

# Tusku kritikon Trumpin për marrëveshjen me Iranin

BRUKSEL, 16 MAJ - Presidenti i Këshillit Evropian Donald Tusk kritikoi presidentin amerikan Donald Trump duke thënë se Bashkimi Evropian duhet të jetë mirënjohës që veprimet e fundit të tij hoqën çdo "iluzion" për bashkëpunim mes kontinentit evropian dhe Shteteve të Bashkuara.
Komentet gjatë një postimi në "Twitter" të Tuskut vijnë si përgjigje ndaj vendimit të Trumpit për t'u tërhequr nga marrëveshja bërthamore mes Iranit dhe kërcënimit të tij për të vendosur sanksione ndëshkuese tregtare ndaj bllokut prej 28 vendesh.
Komentet u bënë përpara takimit në Sofje të krerëve të Bashkimit Evropian, ku pritet të shqyrtohen mundësitë për të mbajtur të paprekur marrëveshjen bërthamore të Iranit dhe për t'i mbrojtur përpjekjet e Unionit për bashkëpunimin ekonomik me Iranin. Më pas krerët e BE-së do të takohen edhe me udhëheqësit e vendeve të Ballkanit Perëndimor.
Bashkimi Evropian nuk pritet të marrë vendime të shpejta pas vendimit të Trumpit për tërheqje nga marrëveshja me Iranin, por pritet që udhëheqësit të vazhdojnë t'u përmbahen dispozitave të marrëveshjes dhe t'i marrin në konsideratë mundësitë për t'i mbrojtur investimet evropiane në Iran, nga të cilat pritet të përfitojnë shumë vende të BE-së.




## Gazi i klorit mund të jetë përdorur në një sulm në Siri



LONDËR, 16 MAJ - Municionet e ndaluara të klorit me gjasë janë përdorur gjatë një sulmi në muajin shkurt në një lagje në provincën Idlib të Sirisë, ka thënë trupi ndërkombëtar për armë kimike, pasi testet laboratorike konfirmuan praninë e kimikatit toksik.
Në raportin e fundit për përdorimin sistematik të municioneve të ndaluara në luftën civile në Siri, Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike (OPXQ) nuk ka saktësuar se cila palë qëndron prapa sulmit në Saraqib, që gjendet në territorin e kontrolluar nga rebelët në provincën Idlib, transmeton "Reuters".
Misioni i OPCW për Siri ka thënë se ka "gjetur se klori është lëshuar përmes cilindrave në Al Talil të lagjes Saraqib", thuhet në deklaratën e organizatës.
Dhjetëra persona ishin trajtuar nëpër qendrat lokale spitalore, pasi kishin pasur probleme me frymëmarrje pas sulmit të 4 shkurtit. Këto përfundime janë nxjerrë pas analizës së dy cilindrave, ku janë gjetur se kanë pasur përmbajtje të klorit.
Organizata për Ndalimin e Armëve Kimike edhe më herët ka thënë se Qeveria siriane ka përdorur agjentin nervor sarin dhe klorin, në sulmet ku janë vrarë dhe plagosur qindra civilë. Ndërkaq, rebelët është thënë se kanë përdorur sulfur mustard në një rast, por me sasi të vogël.
Qeveria e presidentit sirian Bashar al-Assad ka mohuar vazhdimisht se ka përdorur armë kimike dhe i ka akuzuar rebelët se kanë inskenuar sulme të tilla për t'i fajësuar forcat qeveritare për këto mizori.

Nga shkolla kombëtare e Prekazit për progres kombëtar deri në liri, vlera historike dhe filozofike-kombëtare e luftës së UÇK-së 1991-1999 nuk bën të nëpërkëmbet (6)

# Strategji politike për vetëdijesim të elektoratit që të dalë në zgjedhje 80-95 %



Prof. dr. Hakif BAJRAMI

Kriza politike si është përplasur sot në Kosovë, ka rrugëdalje nëse lajmërohen zgjedhjet për një afat gjashtëmujor dhe shteti drejtohet nga një qeveri ekspertësh - teknike si thuhet. Por në zgjedhje duhet të kihet një program dhe të bëhen reforma në përfaqësimin e deputetëve nga komunat e jo të akumulohen në një komunë 20 deputetë e ndonjë komunë mos të ketë asnjë. Pra, deputetët e "vendit" ta përcjellin një propagandë permanente që populli të mos qëndrojë "sehir", por të dalë në votime dhe t'i zgjedhë ata që janë më të mirët. E kush fiton, pastaj le të qeverisë me këtë shtet. Verdikti i popullit duhet të pranohet me objektivitet.

Si të dilet nga kjo krizë. Opozita në shumë raste dëshiron dorëheqje të qeverisë dhe dihet shkuarje në zgjedhje të reja. Kjo rrugë është fare e natyrshme. Por, opozita nuk e dinë se nëse dalin në zgjedhje 43% të elektoratit, prapë do të kemi realitet të forcave të kësaj natyre, mos më keq se sa është sot. Prandaj opozita gjithmonë duhet të jetë e "urtë" me sjellje sepse kështu si po sillet pozita propagandon se kundërshtari po kërkon anarki. Dhe asnjëra palë: pozitë-opozitë nuk do të luftonin me moton: O popull për të dalë nja 80-95% elektoratit në zgjedhje, sepse atëherë do të kishim realitet tjetër. Me gjuhën e shkencës historisë filozofisë politike dhe juridike, kjo do të thotë se nuk kemi "atë për mejdan" me këto ligje dhe me këto kuadro. Dhe, jo që nuk mund të kemi por shkurt partitë politike këtë realitet nuk e duan, sepse do të gjinden para ndonjë Force të re politike, që do ta gjente rreshtimin në shtëpi dhe në Evropën e trazuar, në BE e plagosur, që si duket kur të hyjmë ne, ajo do të shpërbëhet (i lutemi zotit që mos të shpërbëhet). Po kush të investojë këtu kur çdo pushtet po tregon shenja pasigurie. Por, një fakt duhet të dihet, e këtë e themi TROÇ, se shpërbërje të partive dhe qeverisë mund të ketë, por shpërbërje të shtetit të Kosovës kurrë. Ka kaluar koha e vendosjes nëpër tavolina dhe marrëveshje "ilegale" siç është kjo me Serbinë. Se marrëveshja për Asociacionin e Komunave Serbe në Kosovë, është ilegale ka dëshmuar Gjykata Kushtetuese duke i renditë 23 gabime. Nuk ka të drejtë kryeministri të shtihet se nuk ka ditur e në qeveri i ka dy jurist që krekosen se dinë çdo gjë. Po ju tregon puna, realiteti në drejtësi dhe arsim, shkencë e teknologji. Këtë realitet duhet ta mësojnë edhe përfaqësuesit serb në Kosovë, por një fakt duhet të bëhet publik se kurrë me asnjë çmim nuk do të Ju ndodhë atyre si na e kanë bërë ata neve 1981-1999. Këtë garanci e ka në kompetencë Republika e Kosovës dhe qytetarët saj sovran, pa asnjë dallim.

Sot (2016) qytetarët e Kosovës janë shumë të shqetësuar nga një realitet kritik që është krijuar nga trafet politike: pozitë dhe opozitë. Si duket "pikënisja" e kësaj krize është në çështjet e "kryer" nga superstruktura pushtetore, me nënshkrimin në Bruksel të Asociacionit të komunave serbe dhe vendosja definitive e vijës kufitare Kosovë-Mali i Zi (ndryshe demarkacion). Por, niveli i komunikimit të pozitës dhe opozitës, po zbulon diçka më tepër se këto dy çështje, vërtetë si hapa të gabuar të pushtetit dhe jo pushtetit. Po them të gabuar, sepse pozita fare nuk është konsultuar të paktën me opozitën dhe Gjykata Kushtetuese i ka gjetur 23 shkelje të Kushtetutës. Ky faj politikshtetëror, do të duhej të rezulton me dorëheqje të Qeverisë, nëse ka moral civilizues. Çështje tjetër është a do të shkohej në zgjedhje të reja parlamentare. E vërteta, opozita e dirigjuar nga Vetëvendosja, po dëshmon se prej që është lajmëruar në skenën politike, kryesisht është marrë me krijimin e problemeve e jo me zgjidhjen e tyre, përmes dialogut intelektual dhe arsimor. Në fakt, Vetëvendosja si anëtarësi shihet, sa që më fascinojnë me dituri të paktën oratorike, sepse vërehet se kanë zbrazëti të mëdha për njohuritë politike dhe diplomatike e mos të flasim për sjellje taktike dhe gjeostrategjike në veprimtari. Kjo parti, sa i takon nivelit mesatar arsimor politik, në Kosovë del se është shtresë (grupacion politik) më i arsimuari. Kam të drejtë të them këtë sepse qe 40 vjet merrem me politikë dhe prapë them që nuk di. Politika është shumë herë fatamorganë e fotelizmit narcist. Por çka kur veprimtaria nga ky fond i diturisë, po i del gjithnjë si "prift i verdhë". I rëndësishëm por i pa rezultate të pjekura mirë e ofensivë si vlerë pozitive.

Pozita e Kosovës është një konglomerat i stralluar politik i dalë nga ish komunisto-udbashët dhe nga ilegalja patriotike që është mësuar të bëjë punë (hajë bukë) nën sofër. Tash kur e ka bukën në sofër, kjo "ajkë" politike, disi nuk ka as instinkt të mësohet me punën shtetërore shumëdimensionale dhe me mangësi arsimore dihet se është diku në mes. Asgjë kjo shtresë (ky trust politik) nuk ka bërë për themelimin e ushtrisë si garanci e shtetit. Kjo shtresë qe 16 vjet, vetëm ndryshon emra të ushtrisë: TMK. FSK, e tash e synon FAK-un, por nuk ka kush ta themelojë. Të paktën asgjë nuk ka sakrifikuar deri me tash në luksin e saj për të ndërtuar ushtri të mirëfilltë. E pa themelimin e ushtrisë mirëfilltë, Serbia kurrë nuk do t'i ndalë intrigat dhe atentatet politike siç bëri në Bruksel me fajin e dy pushtetarëve. Asnjë pozicion tash nuk e shpërlan nga faji, pse nuk u pranuam në UNESCO, apo pse nuk kemi pranime të reja. Ky fakt është shqetësues.

Ndërkombëtarët, si duket janë lodhë me "hallet dhe dertet" e veta dhe çështjen e Kosovës e kanë ndalë në stacionin e Ahtisarit, diku në stacionin pa stacion. Asgjë nuk kanë bërë në lidhje me zbatimin e ligjit dhe krijimin e një shoqërie të së drejtës. Populli e do këtë realitet, por pushteti është yshtur në hajni dhe korrupsion dhe disa ndërkombëtarëve "pensionistë", që kanë ardhur këtu për ta shpërlarë trurin e tyre, për Kosovën janë një lloj kanceri. Tjetër çështje është pozita e diplomatëve dhe atyre që pushtetarët tanë janë mësuar t'i nderojnë deri në kult dhe tash kur vetëm pak ua kanë kthyer shpinën, për t` i provuar se a dinë të mbajnë shtetinshpinë, këta pushtetarët vendos e kanë treguar fytyrën e tyre prej injorantësh ordinerë. E Kosova, ka dituri, ka trust trunor, por ai po injorohet dhe është koncentruar në "muskujt" e partive që nuk lënë gjë të zezë pa bërë për të fituar vota. Dhe, pastaj lavdërohen dhe formojnë nivele të "kulturës" së tyre zero, përmes asaj vote mjerane, që është e imponuar ose i kontrabanduar. Krejt njësoj.

### Gjuha e inateve është kah lulëzon në Kosovë dhe kriza po thellohet

Kjo qeveri-pushtet, është e mbuluar me injorantë që në profesionin e tyre sot kurrë as nuk kanë ëndërruar. E vërteta, me këtë lloj pushteti partiak nuk mund të nxirret Kosova nga gremina e krizës që ka ardhur nga lartë, nga superstruktura, që e kanë plasuar pushtetarët partiak që janë stralluar nga viti 1999 e deri më sot. Prej natyre baza ekonomike nuk mund të përmirësohet me këtë diktat dhe mentalitet mikropronar. Të rrallë janë ata ministra që e kanë njohuri në profesionin e tyre, lëmin që e kanë drejtuar, ose e drejtojnë. Jo më keq, në stilin "ministri" i dinë të gjitha, bashkëpunëtorët e tyre nuk kanë mund të dinë kurrë më lartë se këta injorantë të zanatit. Po, kryeministri sot është në pozicion si ekonomist, që të transformojë diçka, por në bisedimet që kamë me profesionistët e zanatit të tij, asnjëri nuk i jep notë pozitive. Ndoshta nga inatet, por Kosovës nuk i ndihmohet me inate. Ky njeri ka diplomë dhe doktoratë ekonomisti dhe i ka disa ekonomistë që kanë përvojë dhe dinë të drejtojnë. Së pakut kështu e kualifikojnë edhe në fakultet. Po, ai është bërë "akademik"!!!, por aty cili prej tyre nuk është plagjiator ose bashkë partiak i ish LKJ-së ose LDK-së. E vërteta, akademik nuk është kurrfarë niveli i diturisë mbi qindra intelektualë që janë në epërsi intelektuale karshi tyre. Akademia e Kosovës ishte e klaneve politike dhe ka mbetur derivat i tillë dhe aty kot harxhohen paratë pa një reformë rrënjësore nga poshtë (delegim të akademikëve) lartë drejtimin i saj. Kështu nuk është vetëm në Kosovën e varfër dhe të politizuar skajshmërisht. Po për Kosovën ky realitet është tragjik sepse ende nuk kemi ndonjë vlerë kombëtare nga Akademia, por edhe nga institucionet shkencore që ekonomikisht të orientohemi, të rreshtohemi kah mesi vendeve të zhvilluara.

(Vijon)



E jashtëzakonshme

## Krijohet pajisja djegëse që kthen mbeturinat në energji




Një shpikës amator ka krijuar një pajisje djegëse që lejon familjen e tij t'i riciklojë mbeturinat në shtëpi. Nik Spencer ka thënë se pajisja që ka madhësinë e një makine larëse mund të gjenerojë energji të mjaftueshme për të ngrohur një shtëpi. Prototipat po testohen dhe ai shpreson se një ditë pajisja që ka krijuar do të bëhet e zakonshme dhe e përshtatshme në ambientet e punës.

FOTO E DITES




Një fermer shihet duke i tharë trëndafilat në provincën Jiangsu të Kinës. /AFP/

E rrallë

## Uiski japonez ndalon shitjen




Një degë e "Suntory Holdings Ltd" do ta pezullojë shitjen e dy markave kryesore të uiskit për shkak se nuk i përgjigjet rritjes së kërkesës brenda dhe jashtë vendit. "Spirits Suntory Ltd" ka njoftuar se do ta ndalojë shitjen e uiskit "Hakushu" nga qershori dhe uiskit "Hibiki" nga shtatori. Nuk është bërë me dije se kur do të fillojë shitja e markave përsëri.

## BARSOLETA E DITËS



**Dy policë shkojnë ta marrin rrogën dhe e shohin listën: Kamberi 150 euro, Ndoci 150 euro. Totali: 300 euro.**
**Ndoci pyet: Kush është Totali që nuk e kemi parë kurrë në punë dhe po merr rrogë sa në të dy bashkë?**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjate vikendit në ora 15:00**

### "AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

**Rolet:** Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlet Johansson, Tom Holland, Zoe Soldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

**Regjia:** Anthony Russo, Joe Russo







**Në ora 18:00**

### "ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

**Regjia:** Wes Anderson

**Në ora 16:00 dhe 20:00**

### "DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

**Rolet:** Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

**Regjia:** David Leitch

**Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.**







**Në ora 22:00**

### "I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

**Rolet:** Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

**Regjia:** Abby Kohn & Marc Silverstein

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Ankthi që kishit për ditën e sotme do të venitet shumë shpejt. Pa e menduar do të arrini të mbaroni punë që në orët e para të ditës.



**DEMI**
Jeni të shqetësuar se çfarë do të ndodhë me një problem të caktuar tuajin, por nuk e kuptoni se po i fusni vetes energji negative pa ndodhur asgjë.



**BINJAKËT**
Nëse mendoni që sot duhet t'ju realizohet gjithçka pa bërë asnjë lëvizje, gaboheni rëndë. Gjallërohuni nëse doni të keni rezultate.



**GAFORRJA**
Ju nuk bini asnjëherë pre e rutinës, por dini si të organizoni takime dhe aktivitete që ju vënë në lëvizje. Jeni shumë energjik në punët që keni marrë përsipër.



**LUANI**
Keni mjaft opsione interesante sot për ta kaluar ditën dhe nuk dini kë të zgjidhni. Miqtë duan një ditë në natyrë dhe vendi do t'ju pëlqejë pa masë.



**VIRGJËRESHA**
Ilaçi i ditës tuaj sot do të jenë blerjet. Ata që ju shoqërojnë do të kënaqen sepse ju bëni shumë dhurata.



**PESHORJA**
Sot jeni ju protagonistët e situatave të ndryshme që jua ofron dita. Do të dini t'i bëni zgjedhjet e duhura.



**AKREPI**
Edhe pse dita do të jetë shumë e rrëmujshme, mbrëmja paraqitet e qetë dhe në shoqëri të mirë.



**SHIGJETARI**
Partneri nuk do të kuptoj një takim pune që do t'ju dalë sot papritur. Debate dhe zënka parashikohen gjatë pasdites.



**BRICJAPI**
Keqkuptimet që do të lindin së fundmi nuk do të ndodhin për shkakun tuaj, kështu që nuk keni pse të ndiheni fajtor.



**UJORI**
Mos qëndroni të mbyllur në shtëpi sot. Dita është shumë e bukur dhe duhet shijuar në çdo moment. Do ta kërkoni shoqërinë e një miku.



**PESHQIT**
Sot çdo gjë duket sikur shkon sipas planit dhe nuk do të ndiheni të rrezikuar aspak nga një koleg që ju ka vënë shkopinj nën rrota.

# Firmino në krah të Larissas në jahtin luksoz në Ibiza



Një sezon i jashtëzakonshëm mund të quhet për brazilianin Roberto Firmino jo vetëm në aspektin e futbollit, por edhe në jetën e tij personale. Braziliani është një nga elementët kryesor që ka ndihmuar Liverpoolin ta arrijë finalen e Champions League, ku do të ndeshet me Realin më 26 maj. Firmino ka gjetur kohë për të pushuar me bashkëshorten superseksi Larissa Pereira në një jaht në Ibiza.

# Shannen Doherty i nënshtrohet një operacioni pas betejës me kancerin





Shannen Doherty i është nënshtruar një operimi për rikonstruktim, pas dy vjetësh kur ajo për herë të parë bëri publike se është diagnostifikuar me kancer të gjirit. Ylli i "Charmed" ka postuar një fotografi ku shihet në spital së bashku me nënën. "Urime Dita e Nënës, të dua dhe faleminderit që më ke qëndruar gjithmonë pranë!", ka shkruar ajo.



# Gruaja e Ludacrisit pati një përvojë të keqe gjatë jetës

Gruaja e Ludacris, Eudoxie, së fundmi përdori rrjetin social në "Instagram" për të treguar se në fillim të këtij viti ajo pësoi një abort. "Zot, të falënderoj për dhuratën e jetës. Ky vit nuk ishte edhe aq i mirë për ne", fillon postimi i saj, për të vazhduar: "Kam pasur një abort dhe kisha nevojë për kirurgji". Ludacris dhe Eudoxie u martuan në vitin 2014 para se të prisnin në jetë vajzën e tyre Cadence në vitin 2015.

# Çfarë ka ndodhur me fytyrën e Katy Perryt?



Këngëtarja 33-vjeçare është parë me nënën e vet duke dalë nga një sallon bukurie në Beverly Hills në Kalifornia. Katy është parë me një maskë të bardhë në fytyrë dhe ishte e veshur me tuta të zeza dhe një kapele bejsbolli të markës "Adidas".




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | WOLFSBURG - HOLSTEIN KIEL | 1 | KARLSRUHER - ERZGEBIRGE AUE | 2 | DJURGARDENS - OREBRO | 1 |

# Thaqi: Gjilani nuk ka frikë nga Vëllaznimi

Reprezentuesi i Kosovës, Armend Thaqi, ka bërë me dije se Gjilani nuk ka frikë nga Vëllaznimi, pasi e ka më të lehtë për ta siguruar mbijetesën pa luajtur ndeshjen e barazhit. "Është ndeshja e sezonit për të gjithë ne në klub. Presim një ndeshje të nxehtë në Gjakovë, por nuk kemi arsye të kemi frikë nga Vëllaznimi, sepse jemi më lart se ai dhe presioni nuk është në anën tonë. Atij i duhen tri pikët, kurse neve na mjafton barazimi. Të shohim çfarë do të ndodhë të shtunën", ka thënë Armend Thaqi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PRISHTINË, 16 MAJ - Një prej lojtarëve kryesorë në skuadrën e Gjilanit, Armend Thaqi, ka thënë të mërkurën për "Epokën e re" se skuadra e tij nuk ia ka aspak frikën skuadrës së Vëllaznimit me të cilën përballet në xhiron e fundit të edicionit. Përballja në mes të Vëllaznimit dhe Gjilanit është interesante, pasi skuadrat luajnë për t'i ikur barazhit. "Është ndeshja e sezonit për të gjithë ne në klub. Presim një ndeshje të nxehtë në Gjakovë, por nuk kemi arsye të kemi frikë nga Vëllaznimi, sepse jemi më lart se ai dhe presioni nuk është në anën tonë. Atij i duhen tri pikët, kurse neve na mjafton barazimi. Të shohim çfarë do të ndodhë të shtunën", ka thënë Armend Thaqi, i cili ka shprehur mendimin se skuadra e Gjilanit nuk e ka merituar këtë pozitë. "Konkretizimi i rasteve në shumë ndeshje na ka kushtuar dhe në shumë prej tyre kemi humbur pikët që nuk është dashur, prandaj jemi ku jemi. Gjilani në bazë të lojërave që ka treguar nuk e ka merituar këtë pozitë, por me rëndësi është të sigurojë mbijetesën", ka deklaruar ai.
Reprezentuesi i Kosovës në futboll vazhdimisht është lidhur me një transferim në futbollin e Shqipërisë, por lidhur me këtë Thaqi nuk ka dashur të flasë gjatë. "Për të ardhmen time gjithçka do të vendoset pas ndeshjes që zhvillohet të shtunën, pasi tash nuk është momenti të flas, për faktin se përpara e kemi ndeshjen e vitit dhe shpresojmë ta përfundojmë në mënyrën më të mirë", ka përfunduar Thaqi.
Skuadra e Gjilanit aktualisht pozicionohet e teta me 45 pikë, po aq sa ka skuadra e Feronikelit, kurse Vëllaznimi është një pozitë më poshtë me dy pikë më pak të grumbulluara. Nga 32 ndeshje, Gjilani ka regjistruar 10 fitore, 15 barazime dhe 7 humbje.

# Drejtuesit e KOK-ut sot vizitojnë Gjakovën dhe Deçanin



PRISHTINË, 16 MAJ - Në kuadër të takimeve me komunitetin e sportit dhe biznesit, drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm Shasivar Haxhijaj, sot (e enjte) vizitojnë komunën e Gjakovës dhe të Deçanit. Presidenti Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Haxhijaj, do të takohen me komunitetin e sportit dhe biznesit në të dyja këto komuna. Qëllimi i takimit është sqarimi i rregullores, që përcakton formën, procedurat dhe vërtetimin e sponsorizimit në sport.
Takimet mbahen në sallat e asambleve komunale dhe fillojnë nga ora 10:30 në Gjakovë dhe 13:30 në Deçan. "Drejtuesit e KOK-ut do ta takojnë edhe kryetarin e Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, kurse nga ora 13:00 takohen me kryetarin e Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, me të cilët do të bisedojnë për vazhdimin e bashkëpunimin, organizimin e Ditës Olimpike 2018, si dhe aktivitete të tjera të përbashkëta", thuhet në njoftimin e KOK-ut.
Deri më tani KOK-u ka vizituar edhe Komunën e Pejës, Istogut, Klinës, Mitrovicës, Vushtrrisë, Gjilanit, Dardanës, Ferizajt, Lipjanit dhe Vitisë.

## SHKURT

### Më 26 maj turneu "Lah Nimani"

Federata e Boksit e Kosovës për herë të dhjetë organizon Turneun Ndërkombëtar në Boks "Lah Nimani". Ky turne tashmë është në kalendarin e garave zyrtare të EUBC dhe AIBA-së. Sipas njoftimit të FboxK-së, turneu do të mbahet më 26 maj në orën 12:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Derisa matja zyrtare do të bëhet nga ora 07:00 deri në orën 08:00. Në këtë turne do të marrin pjesë boksierët e rinj 17-18-vjeçar nga Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova.

### Moyes largohet nga West Hami

David Moyes është larguar nga posti i menaxherit të West Hamit pas vetëm gjashtë muajsh në krye të skuadrës, të cilën e shpëtoi nga rënia në Championship. 55-vjeçari drejtimin e West Hamit e mori nga Slaven Biliq, me një kontratë afatshkurtër në nëntor të vitit të shkuar, ndërsa skuadra ishte në pjesën e fundme të tabelës. West Hami siguroi mbetjen në Premierligë duke u renditur i 13-ti. Moyes në të kaluarën e ka drejtuar edhe Evertonin, Manchester Unitedin dhe Real Sociedadin.

### Hamiltoni, afër rinovimit me Mercedesin

Rinovimi i kontratës së Lewis Hamiltonit me Mercedesin është çështje e mbyllur, pasi palët kanë arritur marrëveshjen, edhe pse mungon zyrtarizimi. Disa herë palët kanë konfirmuar dëshirën për ta vijuar bashkëpunimin, që ka sjellë disa tituj kampionë bote te makina gjermane dhe piloti britanik. "Pas garës së fundit në Barcelonë bëmë një mbledhje me të gjithë shefat dhe asnjëri nuk ka probleme. Po flasim për kontratën dhe jemi pranë marrëveshjes, ndaj besoj se shumë shpejt do të hidhen firmat", ka thënë Hamiltoni.

## Hysaj preferon të mos largohet nga Napoli

NAPOLI, 16 MAJ - Mario Giuffredi, përfaqësues i Elseid Hysajt, ka folur rreth gjendjes së tij. Së fundmi shumë lajme janë përhapur se ai do të largohet drejt Manchester Unitedit ose PSG-së, por Giufredi i ka hedhur poshtë këto mundësi. "Besoj se Hysaj do të qëndrojë. Edhe me Sarrin edhe pa të ai do të jetë pjesë e Napolit edhe në vitin e ardhshëm. Edhe nëse Sarri ikën, De Laurentis do të ndërtojë përsëri një ekip të fortë. Dëshira e Elseidit është të qëndrojë. Ancelotti është i madh, por nuk ka një shkop magjik", ka deklaruar Giuffredi.




# Messi: Neymari te Reali? E tmerrshme për gjithçka çka ka bërë te Barça




BARCELONË, 16 MAJ - Kontaktet mes Neymarit dhe Realit po bëhen gjithnjë e më "intensive" në sytë e atyre që janë të magjepsur pas futbollit, e që janë hipnotizuar nga ideja e të parit të kampionit brazilian në krah të Cristiano Ronaldos. Megjithatë, ekziston edhe dikush të cilit i futen drithërima vetëm sa e çon nëpër mend diçka të tillë. Është pikërisht ai që ka kaluar disa vjet duke luajtur përkrah Neymarit, Lionel Messi. "Do të ishte e tmerrshme për mua ta shihja atë me fanellën e Realit jo vetëm në aspektin personal, por për gjithçka ka bërë ai te Barcelona. Do të ishte goditje e fortë, edhe për faktin se do ta përforconte ndjeshëm Realin", ka thënë Messi. "Por unë kam folur me të dhe ai e di mirë se çfarë mendoj unë", rrëfen ai për televizionin argjentinas "TyC Sports".
